



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Financë Kontabilitet”

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Drini Salko

Prof. Dr. Ermira Qosja

Prill / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Financë-Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Kontabilitet - Financë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Financë Kontabilitet
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 330, datë.17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 1 PAK Për sa i përket ngarkesës mësimore 94 % PAE / 6 % PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2021-2022 – 36 studentë Viti 2022-2023 – 27 Studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, (UGJ) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt.12.11.1991, bazuar në Institutin e Lartë Pedagogjik të themeluar në vitin 1971. UGJ i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 15.12.2025. Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
2. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
3. Fakulteti i Ekonomisë;

Në historinë e UGJ, Fakulteti i Ekonomisë dhe njësitë bazë të tij, janë hapur me vendimin Nr. 126, dt. 20.03.2017 të Ministrisë së Arsimit. Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore brenda UGJ, ka në përbërje të tij, njësitë bazë si më poshtë vijon:

- Departamenti i Kontabilitet Financës
- Departamenti i Administrimit Publik
- Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit;

Departamenti i Kontabilitet Financës ofron aktualisht tre programe studimi: Bachelor në kontabilitet Financë; Master Profesional në Kontabilitet Financë dhe Master i Shkencave në Financë Kontabilitet, i cili është hapur me Urdhër MASR Nr. 330. dt.17.09.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Programi MSHFK është përpjekur të reflektojë përvojën më të mirë të masterave shkencor në financë dhe kontabilitet në vend. Ky është akreditimi i parë që do të krijojë mundësinë për përmirësime në vijim, në përputhje të Ligjit Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, udhëzimet që pasuan atë, si dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit MSHFK janë në përputhje të plotë me ato të UGJ dhe kanë të bëjnë me: suksesin e studentëve në tregun e punës. Programi, është konceptuar dhe hartuar me lëndë dhe module, përmban 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite të plota akademike.

Departamenti ka në përbërje 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët: 1 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 6 Doktor shkencash, duke plotësuar kriteret ligjore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Drini Salko dhe Prof. Dr. Ermira Qosja. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Departamenti i Kontabilitet Financës të Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Gjirokastrës, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në FEUGJ, u realizua në datën 8 dhe 9 Nëntor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FEUGJ, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit të Kontabilitet Financës dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë Mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MSHFK, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion dhe dokumentacionin shtesë të ngarkuar në platformën e ASCAL-it. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.03.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 85/6 Prot, datë 29.03.2024. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë njofton në ASCAL më datë 08.04.2024, me anë të shkresës me Nr.529/1 Prot, datë 04.04.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DKF	Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVV	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
MSH	Master i Shkencave
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Rrejtji Akademik Shqiptar
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
SBC	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
UGJ	Universiteti “Eqerem Çabej ” Gjirokastrë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: “Financë Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave (MSH) në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Universiteti “E. Çabej” Gjirokastrë (UGJ), Fakulteti i Ekonomisë (FE), Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës (DKF), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program në fushën e financës dhe kontabilitetit ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në sektorin financiar. Programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e Zhvillimit në UGJ 2020-2025. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore, standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar edhe në Statutin e UGJ (Kreu 1, Neni nr.4: Vizioni.) Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe fushës së financës apo kontabilitetit në veçanti (Statuti i UGJ, Kreu 1, Neni nr.5 dhe 8.) <i>Evidencë nr.1.1..Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.2.Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UGJ-së dhe FE si njësi kryesore e tij, të shprehura në Statutin e UGJ (neni nr.4, 5 dhe 6), Strategjinë e Zhvillimit të UGJ 2020-2025 si dhe Strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit me fokus përgatitjen e

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike, shkencore dhe praktike në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe menaxhimit të riskut. në funksion të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë kryesore/bazë të këtij programi, FE dhe DKF si njësi baze që mbulon këtë program. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve bashkëkohore në fushën e financës dhe kontabilitetit. <i>Evidencë nr.1.1..Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.2.Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidencë nr.7.Strategjia e kërkimit shkencor të UGJ</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është hartuar në përputhje me Statutin e UGJ dhe Strategjinë e Zhvillimit të UGJ 2020-2025 si dhe Strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit. Bazuar në dokumentet baze rregullative të UGJ edhe në rregulloren e këtij programi Kreu II neni 3:objektiva të programit, faqe 2 dhe 3 theksohet pajisja e studenteve me formim akademik shkencor dhe koncepte të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit. Ky program studimi i hapur me urdhër të MASR nr.330 date 17.09.2021, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, DKF, për të zhvilluar këtë program bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të UGJ. <i>Evidencë nr.1.1..Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.2.Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidencë nr.1.3. Vendimi i hapjes se programit të studimit</i> <i>Evidencë nr. 1.6. Rregullore e programit të studimit MSH në FK</i> <i>Evidencë nr. 1.7. Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë nr.7.Strategjia e kërkimit shkencor të UGJ</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar por kryesisht lokal (bazuar në nenin nr 4, vizioni të Statutit të UGJ që thekson zhvillim të qëndrueshëm të Rajonit Jugor). Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e financës, kontabilitetit e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në funksion të këtij vizioni. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e vete programit me fokus sektorin financiar publik dhe privat si

vendas dhe atë ndërkombëtar.	dhe fushën e kontabilitetit që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive në këtë fushë. <i>Evidencë nr.1.1..Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.2.Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidencë nr.1.3. Vendimi i hapjes se programit të studimit</i> <i>Evidencë nr. 1.6. Rregullore e programit të studimit MSH në FK</i> <i>Evidencë nr.2.1. Plan i mësimor MSH në Financë Kontabilitet</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë Kontabilitet" është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UGJ duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Organizimi i UGJ, struktura e tij hierarkike, eksperiencia relativisht e gjatë e institucionit, (që nga viti 1971) kapacitetet dhe burimet njerëzore të njësisë kryesore dhe baze ofrojnë garancinë për ofrimin e një programi MSH në Financë Kontabilitet në përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. FE si njësi kryesore dhe DKF që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Referuar tabelës 1.1 për stafin akademik të FE si njësi kryesore e programit të studimit rezulton se kjo njësi në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje të saj 3(tre) departamente me 22 PAE dhe 10 PAK. Të tre departamentet plotësojnë kriterin e numrit të PAE.

FE është hapur me Urdhër të MAS nr.126, date 20.03.2017 me një strukturë ku përfshiheshin 3 departamente, ku një prej tyre ishte DKF.

DKF si njësi bazë e programit të studimit të MSH "Financë Kontabilitet" bazuar në tabelat anekse nr 2, të RVB gjatë 2 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik në kufirin e plotësimit të kriterit ligjor të operimit të një njësie baze që përbëhet si me poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	1	1
Dr./PhD.	6	-	6	-
Msc.	-	-	-	-
Totali	7	1	7	1

Evidencë nr.3 Anekset RVB (tab 2- 2.1)

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Bazuar në rregulloren së FE, rregulloren e DFK si dhe rregulloren e këtij programi studimi vihet re se ofrimi i këtij programi me fushën e përgjithshme të ekonomisë që është fokus i njësisë kryesore (FE) dhe financë kontabilitetit që është fokus i njësisë baze (DKF).

Bazuar në CV-te e personelit akademik (PAE dhe PAK) që zhvillon këtë program konstatojmë se profili i tyre akademik dhe fusha e kërkimit shkencor përkojnë kryesisht me fokusin e programit MSH në Financë kontabilitet. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të UGJ si dhe nga takimi me personelin akademik të programit konstatuam angazhim të tyre në projekte kërkimore shkencore në fushën e financës. Programet e studimit në FE organizohen në dy nivele edhe në fushën e financës dhe kontabilitetit duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.

Evidencë nr.1.15 .Rregullore e njësisë baze (DKF)

Evidencë nr.2.14.Rregullore e njësisë kryesore

Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet

	<i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i>			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Bazuar në rregulloren e DKF, organizimit të tij shohim që kjo njësi mbulon programe studimi të ciklit të I-re dhe të II-te në fushën e financës dhe kontabilitetit. Aktualisht DKF është përgjegjëse për 3 programe studimi, respektivisht, Bachelor, MSH dhe MP në fushën e finance kontabilitetit. Edhe programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet ” është në përputhje me fushën akademikee kërkimore të kësaj njësie bazë, përgjegjëse për programin e studimit. <i>Evidencë nr.1.15 .Rregullore e njësisë baze (DKF)</i> <i>Evidencë nr.2.14.Rregullore e njësisë kryesore</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Ky kriter nuk aplikohet			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore (FE) dhe baze (FKF) në UGJ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UGJ dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin (Kreu II) rregullore e UGJ, rregullore e programit të studimit MSH në Financë Kontabilitet dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Një pamje të përmbledhur të strukturave përkatëse e jep edhe organigrama e UGJ. Po ashtu janë një sere aktesh të tjera që disiplinojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësiwe e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së programit të studimit. <i>Evidencë nr.1.1..Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.15 .Rregullore e njësisë baze (DKF)</i> <i>Evidencë nr.1.16.Organigrama e UGJ</i> <i>Evidencë nr.2.14.Rregullore e njësisë kryesore</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studenteve, UGJ ka nënshkruar një numer marrëveshje bashkëpunimi me 34 institucione arsimore kërkimore jashtë vendit, 14 marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore shkencore brenda vendit dhe 14 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera që përfshijnë edhe aktore të biznesit. Një pjese e marrëveshjeve të bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS + etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. <i>Evidencë nr. 1.22. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UGJ ka marrëveshesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FE, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën të tyre. <i>Evidencë nr.1.22. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë nr.2.7.Lista e projekteve të UGJ.</i> <i>Evidencë nr.2.8.Lista e mobiliteteve të UGJ</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DKF si njësi baze dhe përgjegjëse e këtij program evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet. GVJ evidentoi në raportin periodik të prezantuar në aplikim ku trajtoheshin rezultatet e bashkëpunimit nëpërmjet të dhënave të shkëmbimeve të studenteve dhe stafeve në kuadër të marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit, realizimin e intershipeve të studenteve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase. <i>Evidencë nr. 2.9. Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore të DKF .2019/2020/2021/2022.</i> <i>Vizita në institucion në takime me stafin akademik dhe studentet.</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Finance Kontabilitet” bazohet në një numër marrëveshesh bashkëpunimi mes UGJ dhe institucioneve mësimore shkencore apo aktore të sipërmarrjeve të ndryshme duke mundur dhe marrjen e eksperiencës pranë tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet, 4 semestra dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë. <i>Duke shqyrtuar planin mësimor të këtij programi studimi, konstatohet që numri i krediteve për të gjitha lëndet është i njëjtë në 6 kredite. Bazuar në faktin se ngarkesa (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit për lende të ndryshme është i ndryshëm logjikisht mendojmë se numri i krediteve për një numër lendesh do të duhet të këtë nën apo mbi 6 ECTS.</i> <i>Evidencë nr.2.1.Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë nr.1.6. Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të	Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet se ai përfshin 15 lende (pa përfshirë praktiken) dhe në të arrihet të transmetohen njohuri me të gjera në fushën e financës dhe kontabilitetit, aplikimit praktik të njohurive në këtë fushë (lëndet, Standardet Ndërkombëtare dhe

përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	SKK në Kontabilitet”, “Menaxhim projektsh” etj) si dhe trajtime teoriko shkencore në lende të veçanta (lendet “Teoria moderne e investimeve”, “Metodat e kërkimit shkencor në financë”) duke përmblusur dhe objektivat e një programi Master Shkencor. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të financës apo kontabilitetit pranë institucioneve financiare apo sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik. Ky program është në vitin e trete të zhvillimit të tij dhe në të nuk është gjykuar të bëhen ndryshime. Bazuar në vlerësimin tone mendojmë që në kuadër të plotësimit të objektiveve të tij, në këtë program ka nevojë të bëhen përmirësime të mundshme të cilat do të shërbenin me mire një programi të ciklit të dytë të studimit në finance dhe kontabilitet të tilla si: <u>Se pari:</u> në programin e studimit duhet të merren me shume njohuri të thelluara të fushës së financës. Për këtë është e nevojshme përfshirja e njohurive të thelluara të menaxhimit të riskut nëpërmjet modulit përkatës të “Menaxhimit të riskut financiar”. Po në këtë kuadër si një program MSH përfshirja e modulit “Drejtimit Portofoli” apo “Vendimmarrja financiare” do përmirësonte me tej këtë program, të mund të ofroreshin në semestrat përkatëse 3 lende me zgjedhje duke krijuar me shume fleksibilitet <u>Se dyti:</u> përfshirja e moduleve të mësipërme në përmirësim të programit mund të realizohet nëpërmjet dy mundësive: ❖ Heqja e lendeve “E drejte biznesi” si një lende e një programi Bachelor në ekonomi, apo lendes “Tregjet dhe Institucionet financiare” njohuri që merren në programin Bachelor; ❖ Përfshirja e me shume lendeve me zgjedhje jo vetëm në vitin e II- por që në vitin e pare. Kjo do të rrisë me tej fleksibilitetin dhe mundësinë e marrjes së njohurive me të thelluara në finance; Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB tab.10
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Programi i studimeve Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”, në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ka përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe

profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	detyrimet përmbyllëse. Parashikohen 12 kredite për praktikën profesionale ose 300 orë gjithsej, nga të cilat 240 orë në auditor dhe 60 orë punë e pavarur nga studentët. Për detyrimet përmbyllëse parashikohen 18 kredite ose 450 orë gjithsej, nga të cilat 90 orë në auditor dhe 360 orë punë e pavarur nga studentët. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit i cili vlerësohet me notë, njëlloj si detyrimet e tjera. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet në këtë program
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në këtë program
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve,	Bazuar në Statutin e UGJ, dokumentacionin e aplikimit pranë ASAL-it si dhe nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se forma

pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi i veprimtarisë akademike kërkimore shkencore realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit. <i>Evidencë nr.1.1.Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion e GVJ</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në planin mësimor të programit vërejmë se ai ka përmbajtje të ngjashme në nivel rreth 70 %, me programe të tjera ofruar nga institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe që kanë të njëjtën/pothuajse emërtësë. FE dhe DFK aktualisht ofrojnë vetëm këtë program studimi MSH me këtë emërtim në Financë dhe Kontabilitet. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion e GVJ</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në RVB, UGJ ka aplikuar në Ministrinë e Arsimit përsa i përket kodit përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet” dhe është në pritje të vendimit nga ky institucion. <i>Evidencë nr.2.33. Shkrese e UGJ; Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në	Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet vetë nga UGJ.

përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë Kontabilitet" organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e mësipërme të GVJ lidhur me këtë program studimi do e përmirësonim me tej atë në drejtim të konsolidimit shkencor dhe aplikativ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FE si njësi kryesore përgjegjëse e programit MSH në “Financë Kontabilitet” përmbush detyrimet ligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafet akademike për zhvillimin e këtij program. Në viti akademik 2022-2023 FE përfshin në strukturën 32 anëtarë si personel akademik nga të cilët 22 anëtarë janë PAE dhe 10 anëtarë janë PAK me kualifikimin e mëposhtëm:		
	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë	
		PAE	PAK
	Prof.Dr	-	-
	Prof.Asoc	4	1
	Dr/PhD	13	-
	Msc	5	9
	Gjithsej	22	10
Njësia kryesore (FE) është e përbërë nga 3 njësi bazë:			

	1. Departamenti i Administrimit Publik; 2. Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës; 3. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit; Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni shikojmë se gjate 2 viteve të fundit DKF si njësi baze përgjegjëse e programit plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik duke pasur një numër të qëndrueshëm stafi por në kufirit minimal të kërkuar, si më poshtë për vitet akademike: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>7</td><td>1</td><td>7</td><td>1</td></tr></table> UGJ ka marre akreditimin institucional me vendim nr.55.date 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL për 4 vite Evidencë : Tabelat përmbledhëse të RVB, nr.1. Evidencë nr.2.12.. Vendim nr.55.date 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	Prof. Asoc.	1	1	1	1	Dr./PhD.	6	-	6	-	Msc.	-	-	-	-	Totali	7	1	7	1
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	-	-	-	-																															
Prof. Asoc.	1	1	1	1																															
Dr./PhD.	6	-	6	-																															
Msc.	-	-	-	-																															
Totali	7	1	7	1																															
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga DKF përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti cakton një pedagog i cili është përgjegjës për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor. Gjithashtu FE ka 3 personel ndihmës akademik në realizimin e punëve laboratorike apo në ndihme të procesit mësimor që në strukturën e paraqitur përfshihen jashtë strukturës se departamenteve . Evidencë . Tabelat përmbledhëse të RVB, nr.1.																																		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një	GVJ bazuar në vizitën realizuar në UGJ dhe dosjen e aplikimit , konfirmon se DKF si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Finance Kontabilitet” ka caktuar si koordinator të programi Përgjegjës in e kësaj njësie i																																		

person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përfundim me objektivat e tij.	cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në auditor si edhe për ndjekjen e praktikave në institucione apo njësi të tjera ekonomike. <i>Evidencë nr.1.15. Rregullore e DKF</i> <i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, shpreh se njësia kryesore FE dhe ajo baze DKF përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në vizitën e realizuar në institucion GVJ evidenton se FE si njësi kryesore dhe DKF si njësi baze e programit kane informacionin e plote mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij program. Stafi akademik në këto njësi nje rregulloren e këtij program, planin mësimor dhe përmbajtjen e programit të lendeve përkatëse që zhvillohen. Informacion rreth programit gjendet dhe në faqen e internetit të institucionit. <i>Evidencë nr.2.1.Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë nr..1.6. Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në	GVJ evidentoi dhe shqyrtoj evidenca të planeve mësimore, rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”, syllabuset e lëndëve ku përfshihet informacioni i plote për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si

semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	leksionet ashtu edhe seminarët, orët jashtë auditorit si puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, duke respektuar VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar “. <i>Evidencë nr.2.1.Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë nr..1.6. Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentet nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/baze, dhe nivel programi kane informacionin e duhur që në procesin e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>Evidencë nr.1.1. Statuti UGJ,</i> <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset) e lendeve të programit MSH në Financë</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë	Duke shqyrtuar programet e lendeve (syllabuset) vërejmë se ato janë ndërtuar si strukture dhe në përmbajtje kryesisht në zbatim të VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar, ku përfshihen: • Emërtimi i lëndës/modulit • Viti/semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentit për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. <i>Nga shqyrtimi i përmbajtjes lëndore (syllabusve) verjeme se:</i> ❖ Në një numër të syllabusve kemi një vlerësim të ulët të studenteve gjatë vitit në masën 10 deri 20 % dhe nivel të lartë vlerësimi në provimin përfundimtar që shkon nga 80 % deri 90 % gjë që nuk respekton siç duhet kriterin e vlerësimit të vazhduar. ❖ Në një numër të syllabusve literatura baze dhe sidomos ajo e rekomanduar i referohet viteve të hershme parapara vitit 2015 gjë që tregon mos reflektimin në program të literaturës bashkëkohore. ❖ Në disa syllabuse edhe struktura nuk është plotësisht sipas kriterëve të caktuar (VKM.nr 41) <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit\Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
--	---

Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e GVJ në ambientet e UGJ shohim që nuk janë bere ndryshime në këtë program i cili tashme është në vitin e trete të zhvillimit të tij. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSH në Finance Kontabilitet është i strukturuar dhe organizuar kryesisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe me objektivat formuese të këtij programi. Në këtë kontekst është e nevojshme përmirësimi në strukture por sidomos në përmbajtje tek seksioni i vlerësimit dhe ai i literaturës duke plotësuar kështu kërkesat ligjore dhe nënligjore por dhe rritur cilësinë e programit lëndor. Përsa i përket këtij standardit II.3, GVJ shprehet se përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e financës dhe kontabilitetit. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit ku është bere një gërshetim mes njohurive teoriko shkencore me ato aplikative dhe të kombinuara me realizimin e praktikës profesionale. Kjo jep mundësi punësimi në tregun e punës

	kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lëndet e fokusuar në objektin e tij që është kontabiliteti dhe financa. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit\Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e financiare dhe kontabilitetit dhe mundësinë për të realizuar kërkime shkencorë në sektorë të veçante të cilat ballafaqohen me natyra të ndryshme të finance, kontabilitetit dhe riskut. Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të riskut. Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën/intershipin të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit\Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në fushën e financës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa dhe kontabiliteti. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim

studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	vazhdimin e studimeve apo punësimit të studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. në kuadër edhe të projektit të përbashkët në hartimin e këtij programi është bashkëpunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Zhvillimi i këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>																										
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kategoria /</th><th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th><th colspan="2">Programi MSC në FK</th></tr><tr><th>Kredite</th><th>Përqindje</th></tr><tr><td>A. LËNDË BAZË</td><td>5%-10%</td><td>12</td><td>10%</td></tr><tr><td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td><td>50%- 60%</td><td>60</td><td>50%</td></tr><tr><td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td><td>12%-20%</td><td>18</td><td>15%</td></tr><tr><td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td><td>10%</td><td>12</td><td>10%</td></tr><tr><td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td><td>10%- 15%</td><td>18</td><td>15%</td></tr></table>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi MSC në FK		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi MSC në FK																							
		Kredite	Përqindje																								
A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%																								
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%																								
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%																								
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%																								
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%																								
	Vlerësojmë se përmbushen kriteret e kategorizimit të lendeve të programit. Megjithatë, në tabelën 9 të pasqyrave anekse tek lendet ndërdisiplinore lënda “Metodat e Kërkimit Shkencor në																										

	Financë” duhet të jete te kategoria A dhe mund të zëvendësohet me lenden “E drejte Biznesi” që është te kjo kategori. Kjo nuk ndryshon plotësimin e kriterit të veprimtarisë formuese. Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program vërejmë se ka një raport të drejte mes formimit teorik dhe atij praktik të studenteve. Nga shqyrtimi i programeve të lendeve shikojmë se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime kryesisht në fushën e kontabilitetit. Trajtimi i rasteve studimore, punëve laboratorike dhe realizimit të praktikës mësimore harmonizon realizimin e objektivave të këtij program. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Ky program është në vitin e trete të zhvillimit dhe GJVJ nuk evidentoi përditësim në programet e lendeve. Në vlerësim, mbeten rekomandimet e GJVJ të dhëna me sipër me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit në tregun financiar dhe kontabël. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi MSH në “Financë Kontabilitet ” i pajis studentët që zotërojnë tashmë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe

	menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet të natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit financiar e bankar por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektorë reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet</i>			
Konkluzione	Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe kualifikimin sipas Kuadrit Kombëtar dhe Europian të Kualifikimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përsa i përket këtij standardi II.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	FE si njësi kryesore dhe DKF si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program ashtu siç edhe e kemi përmendur edhe për vete periudhën e shkurtër të zhvillimit të tij nuk ka pasur ndryshime si reflektim të tregut të punës. Hapja e këtij programi është bazuar edhe në studimin e tregut të punës realizuar nga FE përpara hapjes së programit (Gusht 2021) ku është analizuar tregu rajonal i punës si mundësi e punësimit të të diplomuarve të ardhshëm në finance dhe kontabilitet. Bazuar në tabelën nr.21 të anekseve të RVB shohim që në këtë program janë diplomuar këtë vit (2023) 28 studente që janë dhe kontingjenti i parë që kanë përfunduar programin por që nuk ka Evidencë sa prej tyre janë punësuar. Nga takimi me studentet e programit një numër prej tyre janë punësuar në finance apo kontabilitet. <i>Evidencë nr.1.8. Analiza e tregut të punës për programin MSH në FK.</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Bazuar në vizitën pranë UGJ si dhe nga takimi me studentët e programit, Këshillit studentor dhe pjesëtarë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, si edhe nga rregullorja e kësaj zyre rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar. Po ashtu edhe DKF zhvillon diskutime me studente të këtij programi mbi përmirësime të mundshme në program, por GVJ nuk e evidentoi këtë proces për arsyet e shprehura më lart. <i>Evidencë nr.1.8. Analiza e tregut të punës për programin MSH në FK.</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21.</i>

	<i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	DEF mban kontakte periodike me studentet e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes së tij me tregun e punës. GVJ nuk e evidentoi këtë proces për arsyet e shprehura më lart. <i>Evidencë nr.1.8. Analiza e tregut të punës për programin MSH në FK.</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ eidenton përkushtim të FE dhe DKF në përfshirjen e studenteve dhe aktoreve të tjerë në përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësim të mundshëm të programit në funksion të nevojave të tregut financiar. Përsa i përket këtij standardi II.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet” është i ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin, objektivat e institucionit si dhe në strategjinë e kërkimit shkencor 2020-2025. Ky program studimi sipas rregullores së programit dhe akteve të tjera rregullative të institucionit ka si mision t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. <i>Evidencë nr. 1.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr. 1.2..Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i>

	<i>Evidencë nr. 1.6. Rregullore e programit MSH në "Financë Kontabilitet"</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	FE dhe DKF bazuar në statutin e UGJ bashkërendojnë procesin mësimor e shkencor të programeve të studimit përfshirë edhe këtë program. Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore. <i>Evidencë nr. 1.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr. 1.2..Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidencë nr. 1.6. Rregullore e programit MSH në "Financë Kontabilitet"</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me drejtuesit e FE dhe , DKF dhe stafin akademik të programit.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Ky program studimi u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teorike shkencore por edhe dhe aplikativ. Lendet si "Metodat e kërkimit shkencor, "Drejtimi financiar" apo "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit " përbejnë një fokus i gjere për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative. Megjithatë GVJ nuk evidentoi përfshirje të studenteve të këtij programi në kërkime, projekte dhe aktivitete kërkimore në listën e projekteve ku është përfshirë UGJ. <i>Evidencë nr. 1.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë nr. 1.2..Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me stafin akademik dhe studentet e programit</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Bazuar në statutin e UGJ, planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të institucionit, vihet re se, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore ka mbështetje financiare në kuadër të nje buxheti institucional nëpërmjet alokimit të fondeve në fushat e kërkimit shkencor. Gjate vizitës në institucion GVJ evidentoi financim në teknologji apo procesin mësimor (blerje tekstesh dhe literature shtese) por nuk evidentoi financim të drejtpërdrejtë nga buxheti në fushën e kërkimit shkencor

	për stafin për stafin e DKF. Anëtarë të stafit kane pasur financime në kuadër të projekteve që ka fituar UGJ. <i>Vizita e GVJ në institucion;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni duhet të mbështesë në formë financimi të drejtpërdrejtë stafin akademik të DKF në fushën kërkimore shkencore duke mundësuar një angazhim me efikas të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor, të dhënat e bashkëpunimeve shkencore në rang fakulteti si dhe nga raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të masterit i shkencave “Financë Kontabilitet”, u evidentua se, FE si njësi përgjegjëse nxiti angazhimin e stafit akademik në projektet kërkimore-shkencore kryesisht në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit ose programit ERASMUS, si dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. <i>Evidencë nr. 1.22.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për	Bazuar në strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit si dhe në rregulloren e institucionit dhe atë të vete programit të studimit MSH në “Financë Kontabilitet”, theksojmë se njësia përgjegjëse (FE) dhe ajo baze (DKF), synojnë të angazhojnë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore. Megjithatë, GVJ evidenton një pjesëmarrje jo të kënaqshme të stafit akademik në përmirrje të tyre në projekte kërkimore shkencore. Këtë e tregon edhe fakti që në nivel njësie

realizimin e këtyre objektivave.	kryesore numri i projekteve kërkimore shkencore është vetëm 2 të tilla. <i>Evidencë nr. 1.22.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.19</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Bazuar në tabelat anekse të RVB (tabela nr.19) shikojmë se FE si njësi përgjegjëse e programit nuk ka organizuar konferenca apo aktivitete shkencore. Ky angazhim është realizuar në kuadër të botime të stafit akademik në formën e referimeve në konferenca shkencore, pjesëmarrjes në projekte të tillë apo botimin e librave universitare. Për vete kohën e shkurtër të këtij programi nuk evidentohet realizimi i organizimeve kërkimore shkencore në kuadër të tij. Një drejtim tjetër është realizimi i angazhimit të lektorëve të huaj në prezantimin e temave në fushën e programit ku evidentohet që për këtë program kemi pasur angazhimin e 1 lektori të huaj. Megjithatë, GVJ mendon se FE dhe DKF duhet të jene me aktiv dhe të planifikojnë dhe intensifikojnë punën në rritjen e angazhimit të personelit akademik në fushën kërkimore shkencore, gjë që do të sillte edhe rritjen e kualifikimit akademik të tyre dhe marrjen e titujve akademik (nga 7 anëtarë PAE 6 prej tyre janë vetëm me gradën shkencore Doktor) <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.2, 19 dhe 20</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Referuar programit të studimit (që sapo ka diplomuar kontingjentin e pare të studenteve), përmbajtjes lëndore si dhe studimit të tregut të punës të realizuar në vitin 2021, mendojmë se studentet e diplomuar janë të afte të konkurrojnë në tregun kombëtar dhe sidomos atë lokal të punës. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme	Nuk Aplikohet në këtë program

për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.				
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk Aplikohet në këtë program			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se program i studimit garanton njohuri të thelluara në financë si dhe mundësi kërkimi shkencor të suksesshëm, por që duhet të paraprihen nga një planifikim dhe angazhim me serioz i njësisë kryesore dhe asaj baze përgjegjëse të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Mësimdhënia në programin MSH në “Financë Kontabilitet” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 15 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave me shkronja nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara në vlerësime gjate zhvillimit lendes dhe në provimin përfundimtar. Siç edhe e kemi evidentuar me lart për një numër lendesh të programit vlerësimi gjate vitit është në nivel të ulet deri në 20 %. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit\Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,	Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoit faktin e marrjes parasysh në tre raste të kërkesave të

metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kërkues e shkencor të mësimnxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mire mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. Një zhvillim pozitiv në ndihme të përmirësimit të mësimdhënies është edhe miratimi nga Senati i UGJ në Shtator 2023, të udhëzuesit mbi metodat inovative në mësimdhënie. Ky dokument ka si objekt prezantimin e praktikave me të mira inovative në mësimdhënie (faqe nr.3 e udhëzuesit) dhe është hartuar nga Sektori i kurrikulave dhe standardeve të cilësisë. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë.</i> <i>Evidencë 3.5. Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 3.12..CV e stafit akademik të programit MSH në Finance Kontabilitet</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Bazuar në takimin me stafin e DKF rezultojnë se institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +. Se fundmi miratimi i udhëzuesit mbi metodat inovative të mësimdhënies dhe me e rëndësishmja aplikimi i këtij udhëzuesi në procesin mësimor është një mundësi e rritjes së cilësisë mësimdhënëse të personelit akademik. Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohuri me praktikën e mirandërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të

	dijes. Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom të cilat ishin dhe metoda kryesore gjatë periudhës së pandemisë COVID 19. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneksat e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidencë 3.1./1/2..Urdheri për platformën e mësimdhënies online, implementimin, Manual i përdorimit të platformës TEAMS etj.</i> <i>Evidencë 3.5. Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 3.12..CV e stafit akademik të programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e financës, kontabilitetit si dhe të lendeve të fushave të veprimtarive formuese të tjera .Gjithashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik,përshkruhen në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave. Në vitin akademik 2022-2023 PAE zhvillon rreth 94 % të ngarkesë së programit dhe vetëm 6 % mbulohet nga një PAK duke plotësuar kriterin përkatës. Nga ana tjetër numri i ulet i PAE në DKF që mbulon këtë program por edhe në departamentet e tjera ka bërë që një

	pjese e PAE që zhvillojnë mësim në këtë program të kenë një mbingarkese në auditor prej rreth 400 deri 580 ore mësimore dhe disa prej tyre zhvillojnë 3 deri 6 lende apo module gjithsej duke qene premise për cenimin e procesit të mësimdhënies. <i>Evidencë nr.2.5. Programet lendore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë.</i> <i>Evidencë 3.5. Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 3.12..CV e stafit akademik të programit MSH në Finance Kontabilitet</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr. 4</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentet u evidentua që format tashme të njohura të mësimdhënies nëpërmjet leksioneve, seminareve kane prirje të behën interaktive dhe në forme diskutimi duke përdorur edhe kanalet bashkëkohore të transmetimit të njohurive në funksion të mësimdhënies dhe mesimnxënies. Në kuadër të këtij procesi NJSBC e riorganizuar realizon me studentet tërheqjen e mendimit të tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve formave të mësimdhënies, vlerësimin e pedagoqeve si dhe vlerësimin e lendes. Kjo forme vlerësimi megjithëse nuk ka qene periodike ka evidentuar dhe vlerësuar situatën e mësimdhënies në institucion. në Qershor 2022 Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) ka hartuar raportin e pyetësorëve për mësimin online duke vlerësuar gjithë periudhën mësimdhënëse gjate pandemisë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në njësinë kryesore (FE) dhe atë baze (DKF) me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në takimet me pedagogun e lendes kryesisht për rritjen e trajtimeve me karakter praktik dhe aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. <i>Evidencë nr.3.6. Pyetësor studentor</i>

	<i>Evidencë nr.3.7. Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online</i> <i>Evidencë nr.6.8.Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.5.6.Sondazh kombëtar i studenteve</i> <i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit evidentojmë se tashme janë miratuar dhe operon strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik të UGJ nr.24. date 28.09.2023 . Kjo strukturë tashme e riorganizuar ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësim nxënies të programeve të studimit Institucioni nuk ka njësi të sigurimit të cilësisë në nivel të njësisë kryesore. NJSBC koordinon punën me njësinë bazë që është DKF si njësi përgjegjëse e këtij programi. NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj <i>Megjithatë për një eficecne me të madhe të cilësisë në mësimdhënie kjo strukture duhet të ngrihet edhe në nivel të njësisë kryesore FE. Këtë e argumentojmë me faktin se FE ka vetëm një përfaqësues në NJSBC. Ngritja e këtij komisioni në nivel të njësisë kryesore me anëtarë të vete kësaj njësie do ketë me shume përgjegjësi dhe mundësi për të realizuar objektivat cilësor të mësimdhënies dhe mësim nxënies të programit të studimit. Gjithashtu mendojmë se realizimi i anketimit të studenteve duhet të realizohet periodikisht dhe të evidentohen problematika që ata parashtrojnë në opinionet e tyre për vlerësimin e nivelit të mësimdhënies, pedagoqeve, problematika që në dokumentacionin e paraqitur mungojnë qofte edhe në forme sugjerimi. Kjo do të rriste me shume nivelin dhe rëndësinë e kësaj forme vlerësimi.</i> <i>Evidencë nr.3.6. Pyetësor studentor</i> <i>Evidencë nr.3.7. Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online</i> <i>Evidencë nr.6.8.Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.5.6.Sondazh kombëtar i studenteve</i>

	<i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni garanton realizimin e aftësimit profesional e shkencor me metodat bashkëkohore të mësimdhënies me qendër studentin. Gjate vitit 2023 ka plotësuar kuadrin rregullativ dhe strukturat përkatëse në funksion të cilësisë së mësimdhënies. Megjithatë këto struktura tashme duhet të intensifikojnë punë e tyre si në drejtim të rritjes së cilësisë nëpërmjet metodave interaktive të mësimdhënies ashtu edhe të realizimit sa me efektiv të vlerësimit nga ana e studenteve të procesit mësimor si dhe të vete stafit akademik.</i> <i>Gjithashtu një pjese e personelit akademik ka një ngarkese të larte mësimore dhe zhvillon një numër të larte të lendeve në programe të ndryshme studimore duke përberë premise për ulje të cilësisë së mesimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e studimeve në UGJ, rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit). Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>Siç edhe e kemi theksuar me lart vlerësimi gjate vitit është i ulet, gjë që është përcaktuar dhe në rregulloret e të gjitha niveleve (tek rregullorja e studimit neni 12 është niveli 20 %</i> <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i>

	<i>Evidencë nr.2.5.Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.3.13.Vendim i SA për miratimin e tezes se provimit</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në syllabuset e pedagogëve të programit të studimit MSH në “Financë Kontabilitet” dhe vizitës në institucion u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën e parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. <i>Evidencë nr.2.5.Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit</i> <i>Takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde. <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.2.5.Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit.</i> <i>Takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studentëve gjatë procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të dytë të Kursit të I- të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen deri në një numër lëndesh me 20% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë 80 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programi dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohën e shpalljes së rezultateve , ankimimin e studentet etj. GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura në këtë proces. <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.2.5.Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit.</i> <i>Evidenca nr.3.13.Vendim i SA për miratimin e tezes së provimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pothuajse të gjitha vlerësimet e lendeve të programit realizohen me shkrim në baze të modelit të aprovuar të tezes së provimit. Dy vitet e fundit UGJ ka filluar të aplikojë sistemin e vlerësimit elektronik dhe ka aplikuar disa vlerësime lëndesh me sistemin elektronik të testimit (<i>Projekti clean score</i>). <i>Evidencë nr.3.8.Marreveshje bashkëpunimi AADF me UGJ</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Për realizimin e vlerësimit përfundimtar të dijeve të studentëve DKF, bazuar në rregulloret përkatëse në nivel institucional dhe të vete këtij programi, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të

	firmosfera nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DKF. <i>Evidencë 3.13.1. Model i unifikuar i tezes se provimit</i> <i>Vizite e GVJ dhe takim me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DKF. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në rastet e zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personeli mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Format i tezes se provimit ka si seksion me vete komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezes është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve. <i>Evidencë 3.13.1. Model i unifikuar i tezes se provimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit evidentohet korrektësia e zhvillimit të provimit si me monitorimin nga dy pedagogë anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Mos lejimi i plagjiaturës apo kopjimi gjatë provimit janë të sanksionuar edhe në Kodin e etikës të institucionit neni 25 i tij. <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.3.10. Kodi i Etikës i UGJ</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentet evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës së parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 8 ditëve nga data e zhvillimit të tyre (neni 84 i rregullores së studimit në UGJ), brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korrigjimeve është 5 ditë (nga takimi me stafin akademik). Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të

	provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit student ka 3-5 dite kohe pas shpalljes së rezultatit të vlerësimit që të beje ankese nëse ai ka pretendime për një vlerësim me të lartë. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e student. Atij i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lendes dhe vlerësimin e bere si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. Nga takimi me studentet e këtij program gjate vizitës në institucion ata nuk kishin pasur praktike të tille. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkuar në këtë faze pasi ishte zgjidhur gjate takimit që pedagogu i lendes zhvillon me studentet në datën e paracaktuar para se të hedhe vlerësimet përfundimisht në sistem. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast të kërkesës për ankimim që bën student sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lendes Dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e DKF ngre një komision për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bere transparente procesin me studentin dhe pedagogun e lendes përkatëse. Për këtë program në nuk evidentuam një realizim praktike të tille. <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në planin mësimor, programi i studimit MSH në “Financë Kontabilitet”, bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e pare të studimit në Financë dhe garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. Mbështetur në module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të që në semestrin e parë, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik, profesional dhe relativisht edhe atë shkencor të studentëve. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneket e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë.</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në programin e studimit MSH në “Financë Kontabilitet”, si dhe syllabuseve të lëndëve shikohet se zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër lëndësh të këtij programi. Lende të tilla si “ Metodat e kërkimit shkencor në Financë”, “Teori moderne e investimeve “ apo “Standardet ndërkombëtare dhe SKK të Kontabilitetit” në të cilat përdoren dhe programet aplikative kompjuterike rrisin me tej aftësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit, komunikimin dhe ndërveprimin si aspekte të rëndësishme të fitimit të dijeve në këto fusha. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Aneket e RVB.tab.10</i>

	<i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë.</i> <i>Takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit/seminarit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Përfitimet e marrjes se njohurive shihen të lidhura ngushte edhe me mundësinë e aplikimit të tyre në pozicione të ndryshme të punës në sektorin e financës. <i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar kjo realizohet në lëndët e “Metoda kërkimi shkencor në finance”, “Drejtimit financiar i avancuar”, “Standardet Ndërkombëtare në kontabilitet”, etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator. Eksperienca e stafit akademik si dhe mobilitetet e realizuara prej tyre në kuadër të programit ERASMUS+, apo pjesëmarrës në projektet kërkimore mundësojnë rritjen e nivelit të mësimdhënies. <i>Evidencë nr.2.2.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Evidencë nr.1.6.Rregullore e programit MSH në Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë nr.2.5. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë.</i> <i>Takimi me stafin akademik</i>

Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	UGJ ka një traditë të pasur në zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete të fushave të ndryshme, të cilat realizohen kryesisht në rang institucional. Megjithëse janë në numër të ulët edhe FE dhe DKF organizojnë leksione të hapura me studentet e këtij program duke ftuar personalitete apo specialiste të mirënjohur në këtë fushë me trajtimin e temave të financës apo riskut në ekonomi. në takimin me studentet e programit ata konfirmuan pjesëmarrje në dy leksione të hapura që janë zhvilluar në FE. <i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjatë realizimit të praktikës. <i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i>			
Konkluzione	GVJ evidenton se programi i studimit garanton dhënien e njohurive të gjera teorike shkencore dhe aplikative me tipare të një programi mësimor të nivelit të dytë MSH. Përsa i përket standartit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e programit të

realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	studimit (neni 14) dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës si një dokument me vete. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	DKF, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DKF përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. në ndihme të studenteve për këtë qellim organizohet seanca metodologjike në auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit përmbyllës. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në 8 kritere kryesore (marre nga Manuali i punimit të diplomës): • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Përdorimi i metodologjisë shkencore të punimit; • Origjinaliteti i punimit; • Dobia e punimit; • Cilësia e të shkruajturit; • Paraqitja teknike;

	• Cilësia e prezantimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programi, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë 3.11.2. Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DKF miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbylljen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme. <i>Evidencë nr.3.11.1.Miratimi i fushave të studimit</i> <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo	Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që

jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuar nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare dhe i behet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2022-2023. në rast se studenti kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës së tarifës. <i>Evidencë nr.2.1. Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidenca nr.1.6. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.2.15. Modeli i diplomës MSH në FK</i> <i>Takim në sekretarinë e institucionit</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit. <i>Evidencë nr. 1.27. Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Takim në sekretarinë e institucionit</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka një procedure të qarte të detyrimeve përmbyllëse të studenteve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Ky standard plotësohet plotësisht</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program MSH
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program MSH
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Nuk aplikohet për këtë program MSH

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit,	Bazuar në ligjin për Arsimin e Lartë Nr 80/2015, më specifikisht në nenin 25, Departamenti i Kontabilitet Financës ka në përbërje të tij shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët një anëtar gëzon titullin Prof. Asoc, dhe 6 anëtarë të tjerë janë doktorë shkencash. Gjithashtu, në Departament angazhohet si i ftuar një pedagog i kategorisë Prof.asoc dhe 4 pedagogë me Msc. <i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi të ngarkoheshin në portalin e Ascal-it, CV e plota sipas Europass. Kërkesë kjo që u plotësua.</i> Për shkak të numrit të kufizuar të pedagogëve në departament, ndarja në grup lëndë nuk ishte mundur të bëhet. Gjithashtu, bazuar në Raportet e Veprimtarisë Kërkimore Shkencore Vjetore, evidentohet që pedagogët e Departamentit të

natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Kontabilitet Financës lektorojnë disa lëndë, brenda grupit të Financës, Kontabilitetit, Ekonomiksit, Menaxhimit apo Turizmit, gjithashtu disa prej tyre lektorojnë deri në 8 lëndë. Për shkak të spektrit të gjerë të lëndëve që mbulohen nga çdo anëtar i departamentit, është pak e vështirë të vlerësohet përputhja e fushës kërkimore me natyrën dhe veçoritë e moduleve/lëndëve që mbulohen nga pedagogët. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik për dy vite akademike si më poshtë vijon: 1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 7 pedagogë të gjithë PAE; (100 % PAE) 2. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 1 PAK (88 % / 12 %); <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2021 - 2022</th><th colspan="2">2022 - 2023</th></tr><tr><th>PAE:</th><th>PAK:</th><th>PAE:</th><th>PAK:</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>7</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>7</td><td>0</td><td>7</td><td>1</td></tr></table> <i>Evidencë 3: Aneks tabela: Tab.1; Tab 6.1., 6.2;</i> <i>Evidencë III.4: CV e shkurtuara të personelit akademik</i> <i>Evidencë II.9.1: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2021- 2022</i> <i>Evidencë II.9.2: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2020- 2021;</i> <i>Evidencë II.9.3: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2019- 2020;</i>	Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023		PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	-	-	-	-	Prof.As.Dr	-	-	1	1	Dr/PhD	7	-	6	-	Msc	-	-	-	-	Në total	7	0	7	1
Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023																																
	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																															
Prof.Dr	-	-	-	-																															
Prof.As.Dr	-	-	1	1																															
Dr/PhD	7	-	6	-																															
Msc	-	-	-	-																															
Në total	7	0	7	1																															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e	Nëse do t'i referoheshim udhëzimit Nr. 29/2018 të MAS mbi “Veprimtaritë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-ve” dhe ngarkesës faktike të pedagogëve të Departamentit të KF në UGJ, dukshëm evidentohet që ngarkesa																																		

studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

e kapërcen udhëzimin. Në kushtet e migrimit të pedagogëve, por dhe të një demografia lokale problematike, ***do të duhet që drejtuesit e universitetit të gjejnë zgjidhje dhe strategji, në respekt të kornizës ligjore, por dhe të një raporti cilësi eficientë në procesin mësimor.***

Një zgjidhje mund të ishte duke e konceptuar programin me module dhe duke ftuar profesorë të universiteteve të tjera, ose pedagogët që vijnë me Erasmus Exchange Ka1. Gjithashtu, gjatë takimit me stafin e brendshëm të departamentit dhe drejtuesen e tij, u vlerësua që në vite janë ndërë dhe vështirësi në pagesën e orëve suplementare, mbi atë që lejon Udhëzimi më lart.

Në institucion ndjehet nevoja për disa politika që do të përmirësonin klimën e brendshme dhe do të motivonin pedagogët në punën e tyre, me pak vullnet të drejtimit të universitetit mund të shkohet drejt zgjidhjeve që ruajnë influencën lokale të universitetit dhe ofrojnë mundësi për biznesin në rajon.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (*Evidenca 3. Anekset RVB. Tab 12.1-12.2*), u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
21-22	540	480	60	88.8% / 11.2%
22-23	1020	960	60	94% / 6%

Nga sa më sipër rezulton se për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “*Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi*”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

Evidencë II.11: Tabela përmbledhëse e personelit akademik;
Evidenca 3. Anekset RVB. Tab 12.1-12.2),

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Në se do t'i referoheshim tabelave 2 dhe 2.1 në Aneksat e RVB, evidentohet që në qëndrueshmëria e pedagogëve që japin mësim në program është plotësisht e garantuar. Në program angazhohen 8 pedagogë prej dy vitesh, 7 PAE / 1PAK, të cilët plotësojnë kriteret ligjore. Gjatë vizitës në institucion, evidentuam që dosjet e personelit përmbajnë të gjithë dokumentacionin në përputhje me ligjin, si për stafin PAE, ashtu dhe PAK. <i>Evidencë II.11: Aneks tabela: Tab.2 dhe Tab. 2.1</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015 në nenin 64, specifikon që kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision adhoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit ad hoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së. Në kreun e IV të Statutit të UGJ, në nenet nga 47-59 qartësohen procedurat e punësimit të personelit me kohë të plotë e të pjesshme. Në lidhje me nivelin e duhur të kualifikimit, UGJ bën përpjekje, por zhvillimet lokale dhe kombëtare nuk favorizojnë përzgjedhjen e stafit akademik veçanërisht të kategorisë profesor. Ndërkohë 3 nga pedagogët me gradën doktor sapo kishin nisur procedurën për profesor asoc (të evidentuar gjatë vizitës në institucion) <i>Evidencë 1: Statuti UGJ</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës	Ndonëse në Organigramën e Departamentit të Kontabilitet Financës paraqitet personeli ndihmës akademik, në tabelat përmbledhëse të stafit të departamentit nuk rezulton të ketë në dy vitet, periudhë për të cilin programi akreditohet. <i>Evidencë I.18: Organigrama e departamentit të KF</i> <i>Evidencë II.11: Aneks tabela: Tab.2 dhe Tab. 2.1</i>

specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga takimi me personelin e Degës së Burimeve njërëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton njësia bazë përkatëse, në vijim pritëshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim (<i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ, kreu VI</i>). Zyra e personelit është pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAE dhe një PAK) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion. Gjithashtu, në portalin e Ascal-it gjenden BIO-te stafit, CV sipas Europass të hedhura pas kërkesës së GVJ. GVJ gjen të plotë informacionin në lidhje me lëndët që mbulojnë pedagogët, ngarkesën mësimore, si dhe evidentojmë ecurinë e tyre vit pas viti, natyrisht duke evidentuar dhe problematikët që lidhen me natyrën e lëndëve dhe ngarkesën vjetore që ata mbulojnë, që për të qenë të saktë rritet vit pas viti. <i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ, kreu VI</i> <i>Evidencë II.11: Tabela përmbledhëse e personelit akademik</i> <i>Evidencë III.4: CV e shkurtuara të personelit akademik</i> <i>Dokument shtesë: CV në europass</i> <i>Dokument shtesë: Ngarkesa mësimore e stafit akademik</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,	Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukture për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin e studimit. UGJ dhe FE kanë disa marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me disa institucione dhe organizata në qarkun e Gjirokastrës. Në Evidencë n e dorëzuar portalin e ASCAL, evidentohen rreth 20 marrëveshje, por mungojnë marrëveshjet me biznesin dhe industrinë.

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga takimi i GVJ me përgjegjësin e departamentit dhe stafin e angazhuar në këtë program studimi u përmendën mundësitë në rritje për praktika, intershipte dhe punësim në qytet të studentëve për shkak të zhvillimit të turizmit. Nga ana tjetër studentët e Msc Financë Kontabilitet punonin, shumë rekomandime i kishin marrë nga pedagogët. Për sa më lart, ekspertët e jashtëm, sugjerojnë <i>formalizimin e marrëveshjeve në nivel fakulteti , formalizimin e marrëveshjeve sidomos me subjekte biznesi</i>, duke i dhënë mundësinë studentëve të aftësohen e të krijojnë qëndrime për profesionin në subjekte ku ata dhe mund të punësohen. <i>Evidencë I.22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Duket që praktikave mësimore u mungon një rregullore dhe tërësia e dokumentave apo Paketa e Praktikës Mësimore që bën të mundur ndjekjen e të gjithë ecurisë së studentit në vendin ku ndjek praktikën, përfshirjen e personeli mbikëqyrës në ambientin pritës dhe vlerësimin e studentit në fund të periudhës. <i>GVJ sugjeron që në vijim të përgatitjes së listës së Marrëveshjeve FE – biznes/institucione/organizata të merren në konsideratë dhe praktikat mësimore; si dhe të përgatitet rregullorja dhe Paketa e dokumentacionit të Praktikës.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore, më shumë kujdes duhet në lidhjen e fushës së studimit me lëndët që pedagogët mbulojnë, numrin e lëndëve që një pedagog mbulon, kufizimin e ngarkesës mësimore. E rëndësishme është që drejtuesit e FE dhe UGJ të mendojnë për zgjidhje më strategjike e në funksion të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në portalin e Ascal për infrastrukturën e UGJ dhe Fakultetit të Ekonomisë, GVJ konstaton se insitucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Universiteti zhvillon mësim në tre godina, të cilat plotësojnë kushtet higjeno sanitare dhe të sigurisë, pjesa më e madhe auditoreve dhe zyrave kanë ngrohje qendrore ose të personalizuar me kondicionere. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambientet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. <i>Evidencë I.13: Infrastruktura UGJ</i> <i>Evidencë IV.11: Çertifikatë për sigurinë nga zjarri</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga konstatimi gjatë vizitës në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve dhe seminareve. Godinat ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, plotësojnë kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m²/ student. Në rastin konkret, referuar RVB dhe Aneksit të Tabelave të RVB (Tab.16) normativa në FE-UGJ është 5.6 m² për student. Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit, si dhe kanë akses në EIFI. <i>Evidencë 1: RVB e Msc Financë – Kontabilitet</i> <i>Evidencë 3: Aneksit e RVB</i> <i>Evidencë III.2: Inventari i mjeteve didaktike</i>

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në këtë program studimi nuk zhvillohen laboratore, ndonëse do të ishte pozitive që për një pjesë të lëndëve të kishte programe/softëare. Përsa i përket mundësisë për të aksesuar laboratorë kompjuterësh për përdorim të përgjithshëm, FE dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ka vënë në dispozicion ambientet e laboratorëve që gjenden në universitet. <i>Evidencë III.2: Inventari i mjeteve didaktike</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në institucion evidentuam që në funksion të programit të studimit MSH në Financë Kontabilitet janë dy klasa dixhitale dhe tre laboratorë IT. Klasat dixhitale përpos faktit që kanë të instaluar programe të natyrës financiare, shërbejnë dhe si një mundësi për të realizuar punimet e diplomës për studentët dhe përpunimin e bazave të të dhënave të stafit akademik. GVJ vlerëson që nga pikëpamja infrastrukturore për numrin e studentëve që programi ka, mundësitë ekzistojnë, e rëndësishme është përfshirja e studentëve dhe bashkëpunimi pedagog-student. Vlen të theksohet që UGJ ka marrë mbështetje nga AKKSHI për infrastrukturën e kërkimit shkencor, për projektin e aplikuar në Sisteme dhe Teknologji Informacioni. <i>Evidencë 1: RVB</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera	Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. Institucioni dhe Fakulteti kanë marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me institucione dhe kanë raporte bashkëpunimi mjaft të mira me bizneset lokale, duke u mundësuar studentëve praktikën dhe punësimet e tyre. E rëndësishme është që marrëveshjet duhen formalizuar. <i>Evidencë IV.9, IV.9.1; IV.9.2: Marrëveshje bashkëpunimi</i> <i>Evidencë I.22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (tek shtesat e dokumentacionit pas vizitës)(tek shtesat e dokumentacionit pas vizitës)</i>

praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që FE-UGJ ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nëse do t'i referoheshim silabuseve të lëndëve të ngarkuara në portalin e Ascal-it evidentohet që: <i>tekstet e lëndëve për literaturën bazë ashtu dhe për atë të rekomanduar që përdoren janë kryesisht në gjuhën shqip dhe nuk i përjasin 5 viteve të fundit. Për më tepër, një pjesë e pedagogëve vendosin në literaturën bazë leksionet e tyre të cilat duhet të kenë referencë në një tekst apo tekste.</i> Mënyra e paraqitjes së literaturës nuk është sipas sistemit APA. Gjatë vizitës në institucion, takimit me drejtuesin e FE, drejtuesin e departamentit të FK dhe stafin akademik, diskutimi mbi literaturën e përdorur ishte një nga më të rëndësishmit. Disa prej lëndëve përdorin literaturë bazë të viteve 2000, duke vendosur dijen dhe informacionin që transmetojnë 20 vite pas, për më tepër sistemi fiskal në Shqipëri ka ndryshuar disa herë, ndërkohë që financat, projektet, e drejta në biznes janë impaktuar nga faktorë të ndryshëm e në forma të ndryshme.

	<i>Rifreskimi i literaturës në përputhje me kornizën ligjore, por dhe dinamikat e kohës mbetet një detyrë e parë e rëndësishme nga GVJ për stafin e departamentit.</i> <i>Evidencë II.5. dhe II.5.1: Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ bëri një takim me punonjësit e bibliotekës së UGJ në ambientet e saj. Biblioteka ndodhej në godinën C, me 3 salla leximi, mundësi aksesit përmes kompjuterëve të vendosura në të në internet dhe në bibliotekat online, më specifikisht Jstore të mundësuar nga AADF dhe me një kohë shërbimi deri pasdite për studentët.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, me një vështrim në raftet e librave, por dhe në evidencën e librave të dhuruar të paraqitur në platformën e Ascal-it, evidentohet qartë që librat që lidhen me programin e studimit Msc në FK, janë të kufizuar. Në lidhje me lëndët që mbulon departamenti dhe programet e studimit të tij, shtrohet <i>nevoja për më shumë fonde të universitetit dedikuar librit.</i> Gjatë bisedës me stafin e departamentit ata u shprehën që <i>ka munguar një fond për librin që nga viti 2021, nga administrimi i universitetit.</i> <i>Evidencë III.9. Fondi i librit; U library</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar akses të veçantë në biblioteka online të tilla si: JSTORE, U-Library. Të gjithë studentët dhe personeli akademik i Universitetit të Gjirokastrës “Eqerem Çabej” kanë qasje në përdorimin e Bibliotekës Online “U-Library”. Aksesit në bibliotekën online mundësohet përmes adresës personale të e-mail-it në sistemin EMS në të cilin është regjistruar çdo student apo personel i stafit akademik i UE. Gjithashtu në linkun https://ulibrary.rash.al/ studentëve iu ofrohet tutorial për përdorimin e saj. Në faqen zyrtare të UGJ: https://www.uogj.edu.al/biblioteka-online, stafi akademik dhe studentët mund të aksesojnë online, shërbim i cili ofrohet falas. <i>Evidencë III.9: Fondi i librit; U library</i>

	<i>Evidencë IV.14.1: Biblioteka, Manuali i përdorimit</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka nga pikëpamja infrastrukturore ofron poste leximi dhe poste navigimi e pune në kompjuter. Nga pikëpamja infrastrukturore ambienti është shumë i përshtatshëm për të punuar studentët, individualisht por dhe në grupe në përputhje me nevojat e tyre. Problem i përbashkët i universiteteve shqiptare është aksesimi në librari të tilla si science direct; pearson etj, e cila kërkon një mbështetje të qenësishme nga MAS apo një donator potencial. Biblioteka është në shërbim të studentëve çdo ditë nga e hëna në të premte, nga ora 8 deri në 19, duke i shërbyer studentëve BA dhe MA, në përputhje me oraret e tyre të mësimi, por dhe duke shërbyer si një ambient ku mund të zhvillojnë dhe projektet/detyrat e tyre. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës gjendet i afishuar në hyrje të saj dhe në ambientet e universitetit. <i>Evidencë IV.14.4: Rregullore e bibliotekës.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe	Aderimi në bibliotekën Jstore si një produkt i bashkëpunimit me Fondin Amerikan të Zhvillimit AADF, aktualisht ofron më shumë se 12 milion artikuj në revista akademike, 85000 libra dhe 2 milion dokumente burimore primare në 75 disiplina duke përfshirë formatet e revistave, librave, dhe koleksione dokumentesh. Në lidhje me përditësimin e literaturës në bibliotekë, si reflektim i nevojës së përditësimit në silabuse dhe në kërkim, nevojitet më proaktivitet nga ana e rektoratit dhe administrimit të universitetit, Siç kemi theksuar dhe më lart, që nga viti 2021 (kohë kur është hapur programi i studimit) nuk ka një fond të akorduar për librat/botimet në departament. <i>GVJ sugjeron që departamenti mund të kërkojë dhe brenda projekteve të ndryshme me donator lokalë apo të BE të përdorë një pjesë të garantit për libra.</i>

për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që literatura në silabuset e lëndëve të MSHFK duhet përditësuar në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore, duke i dhënë peshën e duhur literaturës në gjuhë të huaj në literaturën bazë – kryesisht të 5 viteve të fundit, mbi këtë bazë mund të formulohen leksionet e pedagogut të lëndës.</i> <i>Ndërkohë universiteti duhet të përpiqet për të administruar më mirë zërin e buxhetit për librat/botimet veçanërisht kur bëhet fjalë për programet e reja, siç është MSH në Financë Kontabilitet</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, një sërë vendimesh dhe udhëzimesh të MAS, QSHA dhe RASH, Statutin e Universitetit të Gjirokastrës – Neni 44; Rregulloren e Sekretarisë Mësimore menaxhohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët, nga regjistrimi deri në diplomim. Institucioni disponon një sërë rregulloresh dhe procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajisjen me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e Universitetit në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.

	Aktualisht, sekretaria administron një pjesë të informacionit, përmes sistemit Pitagora, të mundësuar nga RASH, i cili ka zëvendësuar plotësisht tashmë sistemin Esse3. <i>Evidencë I.1: Statuti I UGJ</i> <i>Evidencë I.27: Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë IV.15: Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar takimit të zhvilluar të GVJ me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale por edhe elektronike në disa njësi të Universitetit si departamenti, fakulteti, universiteti, njësia e burimeve njerëzore, sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, etj. Njësia e BNJ, është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike dhe Administrative. <i>Evidencë IV.5: Rregullore për organizimin dhe funksionim e DSHNA</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e FE</i> <i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Stafi akademik dhe ndihmës akademik, komunikojnë me studentët nëpërmjet email-ve sikurse edhe nëpërmjet Pitagorës (që ka zëvendësuar Esse3), në të cilin kryhen këto procese: • Hedhje, përditësim i të dhënave të studentëve; • Regjistrimi në lëndë; • Përcaktimi i statusit të studentit; • Komunikimi i personelit me studentët (chat ose mesazhe); • Hedhja dhe përditësimi i të dhënave financiare; • Hedhja e të dhënave kalendarike të provimeve; • Monitorim mbi hedhjen e notave etj; Ne rregulloren për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit në edukim në UGJ paraqiten proceset rregulluese në lidhje me Esse3. <i>Duhet theksuar që institucioni duhet të bëjë një përshtatje të rregullores me sistemin e ri Pitagora</i>

	<i>Evidencë IV.15: Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Gjatë vizitës që GVJ pati në Institucion, në takimin me stafin akademik të programit u evidentua që krahas komunikimit përmes faqes zyrtare të universitetit, email personale, komunikimi me studentët bëhet ndër të tjera edhe nëpërmjet platformës Teams. Në këtë platform, pedagogët mund të informojnë studentët në lidhje me gjithçka për lëndët përkatëse si edhe vendosin leksionet, materialet bazë apo ndihmëse, raste studimi etj. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së procesit akademik, përmes një projekti Erasmus Capacity Building, po pilotohet një platformë Learning Management System “Learning Key”. <i>Evidencë IV.18: Urdhër për përdorimin e e platformës “Learning Key”.</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Kontabiliteti Financës, bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimi, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. GVJ vlerëson të njëjtin problematikë që evidentohet në universitetet publike dhe që ka të bëjë me mungesën e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit (moodle), që do të lidhte studentët me pedagogët, me zyrën e financës, sekretarinë mësimore dhe që do pasuronte në përmbajtje gjithë procesin e administrimit akademik dhe të fakultetit/universitetit dhe natyrisht do përmirësonte cilësinë, përmes mekanizmave të kontrollit.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga vëzhgimi i faqes zyrtare të Universitetit të Gjirokastrës “Eqerem Çabej” https://uogj.edu.al/ vihet re që përmban informacione mbi universitetin, fakultetet, departamentet, dokumentat bazë të institucionit, aktivitetet dhe njoftimet e ndryshme në funksion të studentëve dhe stafit, etj. <i>Faqja zyrtare e UGJ ndonëse e përmban opsionin anglisht, është vetëm në gjuhën shqipe. Për qëllime të ndërkombëtarizimit, por dhe të imazhit të universitetit është e rëndësishme dhe versioni në anglisht dhe pasurimi me BIO-t</i>

	<i>e stafit akademik dhe programet e departamenteve dhe fakulteteve.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që UGJ-FE disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, përmes të cilit administron, informon dhe monitoron aktivitetin akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Përdorimi i sistemeve të integruara të menaxhimit të informacionit do të shërbente për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se IAL harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutit të UGJ, Strategjisë së Zhvillimit të UGJ për periudhën 2020-2025. Projekt buxheti hartohet nga Administratori i UGJ, pas një procesi konsultimi dhe propozimesh nga fakultetet dhe departamentet, dhe kalon për miratim në Bordin e Administrimit të universitetit. Buxheti financiar shqyrtohet nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve në nivel institucional dhe jo në nivel njësie kryesore. <i>Evidencë 1: RVB</i> <i>Evidencë I.1: Statuti UGJ</i> <i>Evidencë I.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ për periudhën 2020-2025,</i> <i>Evidencë IV.16: Propozim Buxheti</i> <i>Evidencë IV.16.4: Projekt buxheti për vitin 2023</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen: a. të ardhura: buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj; b. shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj; Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan buxhet. Po kështu Departamenti dorëzon pranë njësisë kryesore një plan buxhet për mbështetjen e kërkuar nga IAL në funksion të mbarëvajtjes së departamentit dhe programeve të studimit që ai menaxhon. <i>Evidencë 1: RVB</i> <i>Evidencë IV.16.4: Projekt buxheti për vitin 2023</i> <i>Evidencë IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022)</i> <i>Evidencë IV.16.7: Tabelat përmbledhëse, (Tabela 18) të ardhurat dhe financimet për 3 vitet e fundit.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB-së konstatohet se institucioni kryen në mënyrë periodike auditime nga KLSH si çdo institucion tjetër publik, si dhe nga Drejtoria e Auditimit të ministrisë së linjës (MAS). Ndërkohë nga brenda IAL evidentohet që çdo vit bëhen raportimet financiare, ndërsa një dokument të brendshëm auditimi nuk e gjejmë në setin e dokumentacionit. <i>Evidencë IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022)</i> <i>Evidencë IV.17 Raporti i Auditit KLSH</i> <i>Evidencë IV.17.1 dhe 2 Raportet e Auditimit MAS (2018 dhe 2022)</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi	Raportimi mbi buxhetin bëhet në nivel Senati Akademik dhe Bordi Administrimi, ku njësia kryesore ka përfaqësuesit e saj. Për të gjithë mënyrën si procedohet në hartimin e projekt-buxhetit dhe miratimin e tij, si dhe në raportimet vjetore

realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	financiare brenda universiteteve publike, raportimi nuk ka shkuar ende në nivel njësie bazë. <i>Evidencë 1: RVB</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ, duke ju referuar RVB, evidenton se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit megjithatë IAL duhet të bëjë përpjekje në diversifikimin e të ardhurave duke qënë se numri i studentëve ka një trend jo pozitiv. <i>Gjithashtu, pamundësia për për të mirëadministruar ngarkesën mësimore dhe vështirësitë në pagesat e orëve mbi normë, përmbajtja e zërave kryesore të shpenzimeve në universitet, tregojnë që UGJ duhet të jetë më proaktiv për burime nga të tretë, projekte lokale dhe ndërkombëtare.</i> <i>Evidencë 1: RVB</i> <i>Evidencë IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Por gjithashtu vlerësojmë që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për t'u diferencuar në treg në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e programit dhe të ardhurat që vijnë nga studentët dhe nga burime të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë VKM Nr 80 të vitit 2015, UGJ ka sanksionuar në rregulloret e tij në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti një sërë rregullash dhe procedurash që shoqërojnë studentin nga momenti që vendos të aplikojë për programin MSHFK deri në diplomimin e tij. Në Kreun VIII të Statutit të UGJ, Nenin 62 dhe 66, në Kreun VI të Rregullores së universitetit, Neni 51, Në Kreun IV të Rregullores së departamentit të KF si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, studentët gjejnë të shprehur elementët kryesorë të informacionit mbi programet e ciklit të dytë të studimeve dhe më specifikisht MSHFK <i>Evidencë I.1.: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e NJBKF</i> <i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Departamenti i KF dhe Njësia e Karrierës dhe Alumnit, luajnë një rol të rëndësishëm për këshillimin e studentëve në sistem (atyre që studiojnë MSH në UGJ) dhe të aplikantëve të tjerë që vijnë nga tregu i punës në Qarkun e Gjirokastrës. Rregulloret në nivel institucioni, njësie kryesore, njësie bazë dhe programi studimi ,si dhe modalitet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore, bëjnë të mundur garantimin e barazisë në hyrje dhe në trajtim të studentëve gjatë periudhës së studimeve deri në diplomim.
	<i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e NJBKF</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e FE</i>

	<i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Departamenti si rregull propozon çdo vit kuotat dhe kriteret e pranimiit, bazuar në kriteret ligjore, kapacitetet njerëzore dhe ato infrastrukturore dhe më pas ato miratohen në Senat. Duhet thënë që në lidhje me këtë program studimi i vetmi kriter shtesë përpos atyre ligjore për t'u pranuar apo për të transferuar studimet është nota mesatare mbi 7. Në vlerësimin e ekspertëve, në vitet e fundit, për shkak të dinamikave ekonomike dhe sociale, në përgjithësi në programet master kriteret e pranimiit mbeten kryesisht vetën ato ligjore në IAL. Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik u shpreh që programet master janë më pak të suksesshëm nga pikëpamja e numrave të studentëve për shkak të lëvizjeve demografike nga Gjirokastra drejt Tiranës, ose jashtë vendit dhe kjo tashmë është një tendencë kombëtare. Kriteret dhe kuotat e pranimiit bëhen publike dhe në faqen e internetit të UGJ. <i>Evidencë V.2: Kuotat e pranimiit</i> <i>Evidencë V.2.1 dhe 2: Kriteret e pranimiit</i> <i>Evidencë V.2.3: Vendim senati për miratimin e kriterëve dhe kuotave 2024-2025</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në nivel njësie bazë, bëhet një punë e vazhdueshme me studentët e BA, për t'i orientuar në studimet master, për shkak të numrit të kufizuar të studentëve, si dhe ndërveprimiit e komunikimiit dhe miqësor të pedagogëve të departamentiit me ta. Gjithashtu, përmes faqes në internet të UGJ, faqes zyrtare të facebook e instagramit, medias lokale dhe broshurave e posterave synohet të promovohen programet dhe më specifikisht programi MSHFK. Nën këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm, mund të shihen dhe forma të tjera të promovimiit, brenda dhe jashtë institucionit, duke patur në qendër të vëmendjes vlerën që programi krijon për aplikantët që vijnë nga tregu i punës dhe pasurimi i përmbytjes së tij. Bashkëveprimi me industrinë dhe organizatat lokale, mund të jetë një hapësirë që duhet parë si oportunitet për studentë dhe për procese të tjera në UGJ.

	<i>Evidencë V.2.1 dhe 2: Kriteret e pranimit</i> <i>Evidencë V.4.1. dhe 2: fletëpalosje dhe broshurë</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në lidhje me kriterin 6 dhe 7 duhet thënë që institucioni respekton aspektet ligjore të cilat përcillen vit pas vit nga MAS në lidhje me pranimin e kandidatëve që vijnë nga vendet fqinjë shqipfolëse dhe më gjerë, individët me aftësi të veçanta dhe individë që vijnë nga shtresat e marxhinalizuara. Vendimi për kuotat e pranimit të kategorive të studentëve si më lart merret në përputhje me rregulloret e institucionit në senat, pas propozimeve që vijnë nga njësitë kryesore/bazë. <i>Evidencë I.1.: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e NJBKF</i> <i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë V.2: Kuotat e pranimit</i> <i>Evidencë V.2.1 dhe 2: Kriteret e pranimit</i> <i>Evidencë V.2.3: Vendim senati për miratimin e kriterëve dhe kuotave 2024-2025</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në përputhje me rregulloren e UGJ dhe në respekt të aspekteve ligjore dhe administrative, Bordi Administrimit merr vendime në lidhje me ndihmën/mbështetjen e studentëve në ciklin bachelor dhe master. <i>Evidencë II.6. Vendimi i Bordit të administrimit për bursat dhe kategoritë e veçanta</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson së në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit" shkalla e përmbushjes është plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në Rregulloren e UGJ, në Rregulloren e Studimeve, në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik, në Rregulloren e Departamentit të KF, si dhe në rregulloren e programit të studimit MSHFK pasqyrohen në mënyrë të hollësishme procedurat e përparimit akademik. Në krerë respektivë të këtyre rregulloreve (shih më poshtë) gjejmë: kreu “Organizimi i studimeve në përmbajtje të të cilit janë: organizimi i mësimdhënies; frekuentimi, organizimi i praktikave, kalimi në vitin pasardhës, etj, kreun “Kontrolli i dijes dhe vlerësimi “përmban format e vlerësimit të dijes, afatet e provimeve, kushtet e hyrjes në provim, ankimimin, riprovimin përmirësimin dhe mbartjen; kreu që ka të bëjë me procedurat e transferimit, njohjes dhe njehsimit të periudhave të studimit dhe kreu që ka të bëjë me fitimin, pezullimin dhe përfundimi i statusit të studentit. <i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ (Kreu VI dhe VII)</i> <i>Evidencë II.1: Rregullore e studimeve UGJ (Kreu III, IV, V, VI, VII dhe VIII)</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e Fakultetit (Kreu V, VI dhe VII)</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e NJBKF (Kreu IV)</i> <i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit (Kreu II dhe III)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, Statutin e UGJ- Neni 72, Rregulloren e Universitetit – Neni 65 dhe Rregulloren e FE- Nenet 30, 31, Sekretaria Mësimore dhe Departamenti KF, kanë për detyrë të informojnë të gjithë të interesuarit, që dëshirojnë të transferojnë studimet nga një universitet tjetër në UGJ, apo të transferojnë kreditet e marra gjatë zhvillimit të një semestër Erasmus në një vend të BE.

	<i>Evidencë I.1.: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e Fakultetit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo viti akademik dhe semestri, studentët marrin informacion në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, strukturën mësimore, kalendarin akademik, orarin e mësimi dhe pedagogët e lëndëve, në stendat e afishimit pranë sekretarisë mësimore dhe në faqen zyrtare të internetit të UGJ. Elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve qartësohen në silabusin e çdo lëndë dhe përbëhen nga vlerësimi për angazhimin në seminare/detyra e kursit/provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar. Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në sistemin Pitagora, si dhe në vijimësi nga çdo pedagog në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve. <i>Evidencë II.1: Rregullore e studimeve UGJ (Kreu III, IV, V, VI, VII dhe VIII)</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e Fakultetit (Kreu V, VI dhe VII)</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e NJBKF (Kreu IV)</i> <i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë II.5 dhe II.5.1: Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve të UGJ si dhe në rregulloret e tjera institucionale, në nivel Fakultetit, Programi studimi dhe Manualin e Punimit të Diplomës, departamenti organizon dhe sistemon të gjithë veprimtarinë e tij në përmbushje të këtij detyrimi të studentëve dhe fitimit të krediteve, sipas Planit Mësimor dhe kornizës ligjore të programeve master. Procedura e punimit të diplomës nis me miratimin e fushave të studimit, të cilat orientojnë studentët në përzgjedhjen paraprake të temës dhe pedagogut, e vijon më pas në skedulimin e nj sërë veprimtarish, së bashku me pedagogun udhëheqës. <i>Evidencë II.1: Rregullore e studimeve UGJ – Nenet 59 -64</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e Fakultetit- Nenet 39, 40</i>

	<i>Evidencë II.2: Plani Mësimor MSHFK</i> <i>Evidencë I.6: Rregullore e programit të studimit – Neni 6</i> <i>Evidencë III.11.2: Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Evidencë III.11.1: Miratimi i fushës së studimit</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, takimeve me stafin e departamentit të Kontabilitet - Financës, takimeve me studentët që ndjekin MSHFK, njësinë përgjegjëse për Karrierën dhe Alumnin, drejtuesin e FE, vlerësuam që përgjithësisht që bëhet një punë e mirë, brenda disa kornizave që përcaktohen nga faktorë jo në varësi të stafit. <i>Megjithatë, kërkohet më shumë proaktivitet, një lehtësim i pedagogëve nga ngarkesa mësimore dhe shumë punëve administrative që ata bëjnë, në mënyrë që të fokusohen në aspektet zhvilluese të IAL dhe FE.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në lidhje me këtë standard, njësia kryesore dhe bazë ka ngritur strukturën e rregulloreve, kanë vendosur në silabus elementët e duhur dhe kanë ngritur punën në sekretarinë mësimore, në përmbushje të plotë të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit MSHM. Fillimisht përmes faqes zyrtare të universitetit, fletëpalosjeve, komunikimit të drejtpërdrejtë në departamenti, përjasjes komunikuese të njësisë së karrierës dhe alumnit, mediave sociale, dhe afishimeve të posterave në ambientet e universitetit. Programi MSHFK përmban 120 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve plotësuese, lëndë më

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	zgjedhje; praktikës mësimore dhe detyrimit përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 4 semestra, çdo semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë. Në ditët e informimit gjatë javës së parë të mësimit në vitin e parë, studentët informohen nga departamenti KF dhe Njësia e Alumnit dhe Karrierës, për infrastrukturën - godinat në të cilat bëhet mësimi, laboratorët e IT, Bibliotekën etj. Gjithashtu, në përputhje me Statutin e UGJ dhe Rregulloren e UGJ, Sekretaria mësimore dhe Njësia e Karrierës dhe Alumnit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre. <i>Evidencë I.1.: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë I.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë II.2: Plani Mësimor MSHFK</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të vitit të parë të studimeve në MSHFK në FE të UGJ organizohen orët e informimit të studentëve, mbi programin, mënyrën e organizimit të planit mësimor, si ndahen kreditet në leksione/seminare/detyra dhe projekte, detyrimet përmbyllëse që kanë të bëjnë me praktikën mësimore dhe punimin e diplomës. Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin. Informimin mbi silabusin çdo pedagog e bën në orën e parë të mësimit dhe për detyrime të caktuara dhe gjatë zhvillimit të semestrit. Një referencë e vijuëshme për informimin e studentëve mbetet faqja zyrtare https://uogj.edu.al/# <i>Evidencë II.2: Plani Mësimor MSHFK</i> <i>Evidencë II.5: Silabuset e lëndëve të programit MSHFK</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë vizitës në institucion, bashkëbisedimit me studentët, pedagogët dhe drejtuesen e departamenti, ekspertët e jashtëm evidentuan që ndërveprimi mes pedagogëve dhe studentëve në drejtim të orientimit të tyre në tregun e punës ishte pozitiv, ndonëse ishte më shumë joformal. <i>Shtrohet domosdoshmëria e formalizimit të raporteve universitet –biznes dhe kjo të reflektohet dhe në marrëveshjet</i>

	<i>institucionale. Gjithashtu më proaktivitet kërkohet nga Njësia e Alumnit dhe Karrierës, e cila duhet të rikonceptojë detyrat e saj dhe të kuptojë mbi të gjitha nevojën e ndërveprimit me studentët dhe institucionin, si dhe të rikonceptojë mënyrën e mbajtjes së të dhënave.</i> <i>Evidencë II.28: të dhëna statistikore nga zyra e alumnit</i> <i>Evidencë II.29: Të dhëna mbi diplomimin dhe punësimin e studentëve</i> <i>Evidencë IV.5: Rregullore për funksionin e Zyrës së Alumnit</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përmes sistemit Pitagora studentët informohen kryesisht mbi vlerësimin dhe informacione pjesore. Në UGJ mungon një sistem LMS, i cili do të mundësonte informacionin e plotë mbi përmbajtjen e lëndëve, leksionet, seminarët dhe do të krijonte një ndërveprim të rëndësishëm me studentët. Gjithashtu, sistemi do krijonte mundësinë për vlerësimin dhe "auditimin" e gjithë përmbajtjes së lëndëve dhe elementë të tjerë të punës së pedagogut. <i>Në kushtet e një universiteti të vogël, ekspertët e VJ mirëkuptojnë dhe vështirësitë.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në nivel personal pedagogët punonin me studentët, por mbetet shumë më tepër për t'u bërë në drejtim të një dinamike institucionale me studentin në qendër. Zyra e Alumnit nevojitet të përmirësojë veprimtarinë e saj dhe të rikonceptojë funksionin në përputhje me kërkesat e kohës..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UGJ çdo fakultet ka brenda njësisë së administratës, Sekretarinë Mësimore. e cila funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë në portalin e Ascal, janë vendosur dy dokumenta: Rregullorja e Sekretarisë si dhe Rregullorja për krijimin, regjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave në UGJ, e cila rregullon funksionimin e saj. Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikatat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS. MSHFK ka nisur në vitin 2021-2022 dhe tashmë ka diplomuar studentët e parë. <table><tr><th>Viti Akademik</th><th>Studentë të regjistruar</th><th>Nota mesatare në hyrja</th><th>Studentë të diplomuar</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>36</td><td>7</td><td>-</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>27</td><td>7</td><td>28</td></tr></table> <i>Evidencë 1.7: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidencë 10: Rregullore e Sekretarisë</i> <i>Evidencë 16: Rregullore e njësuar për punën me dokumentat</i> <i>Evidencë 3: Aneks i RVB tabela 21 dhe 23</i>	Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrja	Studentë të diplomuar	2021-2022	36	7	-	2022-2023	27	7	28
Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrja	Studentë të diplomuar										
2021-2022	36	7	-										
2022-2023	27	7	28										
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i regjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë mësimore. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, rregjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe përdorimin e Pitagorës, nga ana e Sekretarisë. Gjatë vizitës në sekretari, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën												

	përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mirë të sistemuara. <i>Evidencë 10: Rregullore e Sekretarisë</i> <i>Evidencë 16: Rregullore e njësuar për punën me dokumentat</i> <i>Evidencë 1: RVB</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në RVB, rezulton se ka një kontroll periodik të Njësive kryesore, Njësive bazë, Sekretarisë Mësimore. Nga dokumentat e ngarkuara në platformën e ASCAL-it, kontrolli duket shumë skematik. Megjithatë, ekspertët vlerësojnë <i>do të ishte më pozitive një kontroll periodik më tematik dhe jo kaq gjeneralist</i>. Një kontroll i tillë do të shërbente në përmirësimin e cilësisë së proceseve brenda universitetit dhe të reputacionit të tij <i>Evidencë V.& dhe V.7.1: Kontrolle dokumentacioni</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UGJ, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi. Një Raport i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, një raport tjetër në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbejnë dhe për të përditësuar programin. <i>Evidencë I.24.1 deri 4 : Analiza vjetore e departamentit</i> <i>Evidencë II.28: Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UGJ mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna për studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, bazuar në rregulloret e brendshme, kryesisht në mënyrë manuale.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Në Statutin e UGJ (Neni 88) dhe në Rregulloren e Organizimit dhe funksionimit të tij (Kreu III) nene të caktuara i dedikohet të drejtës së studentëve të përfaqësohen në organet e Universitetit, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Sipas Statutit të UGJ, në Senatin Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. Gjithashtu, studentët janë pjesë e Njesisë së sigurimit të standardeve të cilësisë; - komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët; grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë. Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë Këshillat e Studentëve të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të	Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje. Pjesëmarrja e studentëve në disa komisione, në Senat, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimit të programeve, MSHFK përfshirë.

përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Element i pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të tij, përmes pyetësorëve, që krijon mundësinë e analizave të mëtejshme, por që në formën që bëhet është shumë gjeneralist, nuk është në terma të përmbajtjes së lëndës, të mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, duke mos kontribuar drejtpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës dhe dinamikës gjatë studimeve. <i>Duhet bërë më shumë për të krijuar traditën e fokus grupeve, mbledhjeve periodike dhe mbështetjes për hapat më tej të karrierës së studentëve.</i> Institucioni ndjehet që ka nevojë për një dinamikë tjetër, një qasje me optimiste e drejtuesve, pedagogëve dhe studentëve, sepse Gjirokastra sot është një destinacion i rëndësishëm për industrinë e turizmit dhe investimet publike e private që vitet e fundit janë rritur. <i>Evidencë 1.1: Statuti UGJ</i> <i>Evidencë 2 : Rregullore UGJ</i> <i>Evidencë 1.26: Lista e anëtarëve të senatit akademik</i> <i>Evidencë II.29.1: Lista e anëtarëve të këshillit studentor</i> <i>Evidencë II.29: Statuti i Këshillit Studentor</i> <i>Evidencë V.8: Rregullore e zgjedhjeve për këshillin studentor</i> <i>Evidencë V.13.1: Urdhër për ngritjen e GVB për Këshillin Studentor</i> <i>Evidencë V.9.: RVB, Tabela 24 të dhëna për anëtarët e NJSBS</i> <i>Evidencë III.6: Pyetësori për studentët</i> <i>Evidencë III.7: Raporti mbi rezultatet e pyetësorit për studentët për vitin 2021-2022</i>
Konkluzione	<i>UGJ përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre” vlerëson që përtej pjesës formale ka hapësira për përmirësim, vecanërisht të klimës në universitet.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloret intitucionale në nivel universiteti dhe fakulteti, në shërbim të informimit të studentit dhe të përparimit të tij në sistem nga momenti që kërkon informacion mbi programin, deri në diplomimin e tij, janë një sërë zyrash brenda njësisë kryesore dhe në rang universiteti. Kështu, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sekretaria Mësimore e Fakultetit, Zyra e Financës, Zyra e IT, vetë departamenti, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë i shërbejnë “udhëtimit” të studentit në MSHFK, por dhe oportunitetit për Erasmus Exchange në një nga universitetet perëndimore. <i>Ekspertët e jashtëm vlerësojnë që njësia e karrierës dhe alumnit do të duhet të ndërgjegjësohet për rolin dhe rëndësinë që ka zyra e tyre, ndërveprimi dhe komunikimi vazhdueshëm brenda dhe jashtë universitetit është shumë i rëndësishëm për të prodhuar rezultat.</i> Gjatë takimit të ekspertëve me studentët në FEUGJ, ata në përgjithësi u shprehën pozitivë për eksperiencën e tyre në programin MSHFK. Do të kishim mirëpritur një mendim kritik, një përjasje zhvilluese dhe më proaktivë në raport me përmirësimet në programin MSHFK apo procesin në universitet, aktivitetet e funksionalitetin e zyrave në institucion etj. <i>Sugjerojmë më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i>

mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e karrierës mban statistika në lidhje me punësimin e studentëve, por në rastin e programit MSHFK, ky është brezi i parë i diplomimit të studentëve dhe në momentin e hartimit të RVB cikli I studimit nuk ishte mbyllur. <i>Evidencë 1.1: Statuti UGJ</i> <i>Evidencë 2 : Rregullore UGJ</i> <i>Evidencë IV.5: Rregullore për funksionimin dhe organizimin e DSHNA</i> <i>Evidencë V.14 : Formular për gjurmimin e studentëve</i> <i>Evidencë II.28: Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit</i> <i>Evidencë II.28.1: Database Alumni</i> <i>Evidencë IV.5: Rregullore për funksionin e DSHNA</i> <i>Evidencë V.14.2: Plani vjetor për këshillimin e karrierës</i> <i>Evidencë V.14.1.: korrespondenca për këshillimin e karrierës</i>			
Konkluzione	<i>UGJ ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët” vlerëson që ka vend për më shumë dinamikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në aspektin formal, Universiteti Gjirokastrës dokumenton përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kjo evidentohet nga një sërë dokumentash si: - Strategjia për përmirësimin e cilësisë; - Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies; Gjithashtu pjesëmarrja e pedagogëve të angazhuar në programin e studimit MSHFK, në projekte për ndërtim kapacitetesh tregon përpjekjen e stafit dhe rëndësinë që këta të fundit ju japin metodave të mësimdhënies të bazuara në kompetenca. Në këtë kuadër është dhe përdorimi i platformës Learning Key – një opsion i platformave moodle. Institucioni ka hartuar në nivel instiucional udhëzues për përdorimin e platformave online, si Microsoft Teams, etj që lindi si nevojë gjatë Covid 19. Duhet thënë që këto nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar në nivel institucional përpjekjet për metoda të ndryshme innovative në mësimdhënie. <i>Evidencë III.5: Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies;</i> <i>Evidencë III.5.2: Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i> <i>Evidencë I.28.2: Forcimi i kompetencave në mësimdhënie-kompetenca didaktike;</i> <i>Evidencë III.1: Urdhër për përdorimin e platformës online</i> <i>Evidencë IV.8: Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe	Bazuar në kornizën ligjore, në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë si dhe në Statutin e UGJ ka dy struktura bazë për kontrollin dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies: - Njësia e Sigurimit të Cilësisë;



inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	- Sektori i Standardeve, Cilësisë dhe Kurrikulave; Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 103 të Statutit të UGJ, Senati Akademik i UGJ me Vendimin nr. 24, datë 28.09.2023 “Për miratimin e NJSBC”, ka përcaktuar përbërjen e NJSBC. Siç vihet re kjo njësi është krejt e re dhe kuptohet që ka shumë punë përpara dhe shumë veprimtari për të ngritur dhe kthyer në kulturë institucionale. SSCK përmes një tërësie procedurash organizon një sërë veprimtarish vjetore që në thelbin e tyre synojnë monitorimin, vlerësimin dhe promovimin e cilësisë, përmes instrumentave statistikore, database-t mbi vlerësimin semestral dhe vjetor të pyetësorëve të studentëve, raporte të ndryshme analitike, etj. GVJ vlerëson pozitivisht këtë përpjekje të institucionit për të hartuar strategji, raporte vjetore, të cilat do të orientojnë në arritjen e qëllimeve, megjithatë nga vizita në IAL vihet re <i>që ka një hendek midis asaj që paraqitet si strategji dhe aplikimit konkret të instrumentave, si dhe gjetjet apo monitorimi i këtyre aktiviteteve.</i> Për shembull problematikat që reflektojnë syllabuset e lendeve të MSHFK tregojnë që strukturat përgjegjëse për cilësinë duhet të jenë më proaktive dhe të kenë sinergji me njësitë e tjera në nivel departamenti dhe fakulteti për të siguruar së pari respektimin e kornizës ligjore dhe sy dyti arritjen e objektivave të paraqitura në strategjitë e ndryshme. <i>Evidencë III.5.2: Strategjia për përmirësimin e cilësisë</i> <i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i> <i>Evidencë VI.8.1. Përbërja e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021</i> <i>Evidencë VI.6.2: Plani vjetor i SSCK</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	përmirësimin e programit të studimit. GVJ vlerëson që pavarësisht ekzistencës së kornizës institucionale të SSCK më shumë përpjekje duhen bërë nga kjo njësi për të operacionalizuar objektivat që i ka vendosur vetes, të paraqitura në Statut UGJ por edhe në rregulloren e NJSBC-së. Raport përmbledhës i NJSBC ofron vetëm një përgjigje të reduktuar të gjetjeve të pyetësorit të studentëve pa një narrative konkrete në lidhje me masa të tjera për sigurimin e cilësisë. <i>GVJ rekomandon, që NJSBC dhe SSCK duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të krijuar instrumenta të vlerësimit 360 gradë të programit të studimit, të shtrihet në aktorë të tjerë që lidhen direkt ose indirekt me programin e studimit.</i> Paketa e vlerësimit të cilësisë e përbërë nga: 1. ANALIZA SWOT (Analiza realizohet nga pedagogu i cili bën një vet vlerësim në lidhje me leksionet, seminarët, detyrimet e studentit); 2. Pyetësor për studentët për programin e studimit; 3. Pyetësori për studentet që kane përfunduar studimet në UGJ në lidhje me kënaqësinë e studentit në program dhe universitet; 4. Pyetësori për punëdhënësit; 5. Formular vlerësimi i personelit akademik i cili zhvillohet në fund të çdo viti akademik nga drejtuesi i njësisë bazë, duhet të shërbejnë për të krijuar një plan konkret monitorimi dhe vlerësimi si dhe një plan vjetor aktivitetesh; <i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i> <i>Evidencë III.6.1 dhe 2: Pyetësorët për studentët sipas viteve</i> <i>Evidencë III.7: Raport i SCBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, dokumentohen duke ju vënë në dispozicion drejtuesve të njësisë dhe kryesore por nga analiza e dokumentave të vëna në dispozicion vihet re vetëm analiza e pyetësorit drejtuar

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	studentit në të gjitha njësitë kryesore të UGJ përfshirë këtu edhe rezultatet e pyetësorit të FE. Por se si këto rezultate janë përdorur në qëllim të përmirësimit të programit të studimit nuk mund të vlerësohet pasi mungojnë evidenca. Po kështu nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi mungonte feedback që ata kanë sepse ata nuk janë të informuar sa duhet për procesin dhe rolin që ata kanë në përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidencë III.7: Raport i NJSBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ nuk mund të japë vlerësim në lidhje me këtë kriter pasi mungojnë evidenca për këtë pikë. Prandaj është e nevojshme që njësia e sigurimit të cilësisë të krijojë mekanizma për ta vlerësuar dhe promovuar më pas.			
Konkluzione	GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të institucionalizuar procesin e matjes, krijimi të indikatorëve dhe më pas monitorimit e vlerësimit të cilësisë për programin e studimit në fjalë dhe në përgjithësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për	Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nenit 94 të Statutit të UGJ,

Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Vendimit të Senatit Akademik nr. 24, datë 28.09.2023 “Për miratimin e NJSBC”, Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit miraton formatin dhe modalitetet e pyetësorit institucional të studentëve Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka këto detyra: 1. Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies; 2. Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore; 3. Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi; <i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar indikatorë të matjes së cilësisë që bëjnë të mundur monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i> <i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i> <i>Evidencë III.6.1 dhe 2: Pyetësorët për studentët sipas viteve</i> <i>Evidencë III.7: Raport i SCBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	IAL ka ngritur aktet rregullatore në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, megjithatë nuk mund të evidentohet nëse ka një plan masash për të monitoruar cilësinë e programeve të studimit dhe instrumentat që do të përdoren për ta vlerësuar dhe monitoruar atë. <i>Universiteti në nivel fakulteti si edhe Departamenti, duhet të formalizojë takimet me subjekte/biznese, si dhe të angazhojë bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> <i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për ta bërë aktiv këtë komponent.</i>

	<i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i> <i>Evidencë I.2: Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Ky proces vlerësimi i jashtëm, por edhe RVB i realizuar nga stafi i njësisë kryesore dhe bazë ka për qëllim ta ndihmojë institucionin të përmirësojë praktikën në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Nga takimet me stafin e angazhuar në programin e studimit u pranua se më shumë praktika duhen dokumentuar dhe institucionalizuar dhe se proceset e akreditimit janë një mënyrë për të nxitur IAL-në në këtë drejtim dhe ata e konsiderojnë shumë pozitive praktikën e krijuar në këtë akreditim të parë të programeve. UGJ i është nënshtruar riakreditimi institucional në vitin 2021, rekomandimet e dhëna nga Bordi i Ascal-it evidentojnë se strukturat e IAL duhet të bëjnë përpjekje në disa drejtime për të përmirësuar cilësinë e proceseve në të. <i>Evidencë I.28: Vendimi i akreditimit institucional periodik</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL vihet re se akoma institucioni nuk ka konsoliduar një paketë indikatorësh dhe plan aktiviteti për procesin e monitorimit të cilësisë përveç pyetësorit të studentëve. Këtij të fundit duhet ti bashkëngjiten edhe instrumenta të tjerë.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar një paketë dhe plan veprimi për monitorimin e cilësisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në evidencat dhe dokumentat strategjike të cituar më sipër, IAL ka paraqitur në mënyrë specifike objektivat në lidhje me mësimdhënien dhe përmirësimin e saj,, dhe në RVB gjithashtu citohet vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm si një metodologji e strukturuar për të marrë masa në lidhje me promovimin dhe adresimin e gjetjeve. <i>Nëse i referohemi pyetësorëve të studentëve, përmbajtja e pyetjeve mendojmë e sugjerojmë që duhet riparë e rikonceptuar, pyetësorë për të gjithë dhe për cdo program, e nivel studimi nuk mund të të orientojë me gjetjet e veta në praktika të përmirësimit të vazhdueshëm.</i> Gjithashtu, <u>GVJ rekomandon</u> dhe instrumenta alternativë, si fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamentit me studentët, tryezat me industrinë etj <i>Evidencë 1: RVB</i> <i>Evidencë III.6.1 dhe 2: Pyetësorët për studentët sipas viteve</i> <i>Evidencë III.7: Raport i SSCK mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga	Si u përmend më sipër IAL realizon pyetësorin e studentëve si detyrim institucional, rezultatet analizohen por nuk ka praktikë për përfshirjen e rezultateve për të motivuar apo marrë masa të caktuara në vijim të përmirësimit të cilësisë. <i>Evidencë III.7: Raport i NJSBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021</i> <i>Evidencë I.24.4: Raport vjetor i UGJ 2021-2022</i>

personeli akademik dhe studentët.	<i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport i veprimtarisë mësimore shkencore të FE viti 2020-2021</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Përpos realizimit të pyetësorit të studentëve, njësitë bazë/kryeore realizojnë vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të studentëve sa i përket psh mesatares në hyrje dhe dalje, punësimit të tyre etj. Ndërkohë që kryejnë testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidencë I.24.4: Raport vjetor i UGJ 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.6 dhe VI.6.1: Raport i veprimtarisë mësimore shkencore të FE viti 2020-2021</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL përveç anketimit të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, nuk evidentohen metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe, intervista të hapura, fokus grupe etj. <u>GVJ sugjeron kryerjen e sondazheve por edhe aplikimin e planeve të veprimeve në rast të evidentimit të mangësive, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</u>

apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	GVJ vlerëson që IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, por ky proces duhet të pajiset me praktika monitoruese dhe vlerësuese për të siguruar një analizë të vazhdueshme të programit të studimit. Këtë konkluzion e ka nxjerrë edhe vet IAL në rekomandimet e paraqitura në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UGJ ka ngritur strukturat për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj. Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet në nivel strategjik pra në Statut të UGJ dhe rregullore të FE ngritja e këtyre strukturave por nuk ka një rregullore të posaçme për standardet e sigurimit të cilësisë së brendshme. Kjo vjen edhe për shkak të kohës së shkurtër që strukturat janë ngritur në nivel institucional. Nga vizita në IAL u kuptua fryma pozitive dhe angazhimi për ta çuar përpara këtë proces.
	<i>Evidencë 1.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i>

	<i>Evidencë VI.8.1. Përbërja e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.6.2: Plan i vjetor i SSCK</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	<i>GVJ evidenton që Rregullorja e NJSBC është miratuar në Senat në shtator të vitit 2020, ndërkohë përbërja e NJSBC është miratuar në Shtator 2023. IAL kërkon kohën e vet për të vendosur në baza të një sistemi të integruar të menaxhimit të cilësisë veprimtarinë e vet, kuptuar, si politika e cilësisë, procedura, rregullore dhe instruksione. Në Rregulloren e NJSBC përcaktohet: Misioni dhe struktura NJSBC; Objekti i veprimtarisë së saj; gjithë veprimtaria për përmirësimin e kurrikulave dhe vlerësimi i cilësisë së programeve dhe kërkimit shkencor.</i> Ndjejhet nevoja e integritetit të rregulloreve institucionale me Statutin dhe Kornizën Ligjore të Garantimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përfshirë këtu raportet mes NJSBC dhe SSCK, departamentit dhe FE. Departamenti i Kontabilitet Financës është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Përfshirja e anëtarëve të tij në procesin e vlerësimit të programit të studimit MSHFK është një mënyrë përfshirje dhe angazhimi për të përmirësuar në vazhdimësi cilësinë. Megjithatë, GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje për të rregulluar procesin e vlerësimit në një plan 360 gradë në të gjithë komponentët e programit të studimit. Kjo e fundit patjetër që kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve që kanë lidhje direkte dhe indirekte me programin e studimit dhe përmirësim të vazhduar të institucionalizimit të proceseve që lidhen me të. <i>Evidencë I.1: Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë VI.8. Rregullorja NJSBC</i> <i>Evidencë VI.8.1. Përbërja e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.6.2: Plan i vjetor i SSCK</i> <i>Evidencë IV. 5. Rregullore për funksionimin dhe organizimin e DSHNA</i> <i>Evidencë II.14: Rregullore e FE</i> <i>Evidencë I.15: Rregullore e Departamentit të KF</i> <i>Evidencë I.16: Rregullore e Departamentit të KF</i>

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga vizita në IAL u kuptua që ky kriter plotësohet për proceset e vlerësimit që janë realizuar deri tani, përmendim këtu që IAL ka kaluar një proces të vlerësimit dhe akreditimit institucional. Ky i fundit e ka ndihmuar institucionin të identifikojë fushat e përmirësimit në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Evidentimi si pikë e dobët dhe më tej si rekomandim në procesin e vlerësimit dëshmon hapin e parë në procesin e vlerësimit. <i>Evidencë 1: RVB</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga vizita në IAL dhe shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet që ekspertë të jashtëm apo bashkëpunëtorë të tjerë nuk janë të përfshirë në procesin e vlerësimit. Kjo vjen edhe për shkak se IAL është në hapat e para të konsolidimit të këtij procesi. Megjithatë GVJ këshillon që aktorët e biznesit të zonës së Gjirokastrës të cilët janë suport për FE mund të përfshihen një proces pooling paraprak. <i>Evidencë VI.8.1. Përbërja e NJSBC</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ka bërë përpjekje për të përfshirë njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit por ky proces ka nevojë për përmirësim të mëtejshme në drejtim të: praktikave të vlerësimit, institucionalizimit të tyre si dh përfshirjes së një baze të gjerë studentësh dhe aktorë me ekspertizë në tregun e punës..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të internetit të UGJ, në menune e transparencës gjenden dokumentat e mëposhtëm: - Akreditimi institucional; - Përbërja e NJSBC – koordinatori institucional; - Raporti auditit dhe buxheti; Si dhe programi i transparencës që përmban informacione/raporte etj, në shërbim të publikut, stafit dhe studentëve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e UGJ. Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave mbi programet e studimit dhe përmirësimi i tyre. Nga shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e UGJ, nuk rezulton që të jetë çënuar liria akademike apo të dhënat personal. <i>Evidencë VI.6. Raporti vjetor i SSCK 2020-2021</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur në platformën e ASCAL, RVB rezulton që UGJ ka formuluar një plan masash për akreditimin institucional dhe një vendimmarrje të Senatit akademik për këtë plan masash. Ndërkohë Raporti vjetor i SSCK është analitik, ai konstaton por nuk mban qëndrim dhe nuk përcakton një plan masash për institucionin. Duhet thënë që programi Mastër i Shkencave në Financë – Kontabilitet akreditohet për herë të parë, kështu që në mënyrë të natyrshme nuk mund të ketë ende një plan masash <i>Evidencë VI.6. Raporti vjetor i SSCK 2020-2021</i> <i>Evidencë I.29. . Plani I veprimit për akreditimin institucional</i> <i>Evidencë I.29.1: Vendimi I Senatit Akademik për miratimin e planit të masave</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në	Nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj. GVJ vlerëson që ky proces është në zhvillim e sipër dhe nuk mund të gjykohej akoma për efektivitetin dhe impaktin që ka në sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSHFK.

vijim të cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni mund të ketë organizuar veprimtarinë relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Në RVB evidentohen referenca që nuk kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit të cilësisë. Ashtu si u përmend edhe më lart, nga vizita në IAL, stafi u shpreh pozitiv për rëndësinë e procesit dhe po bën përpjekje për të krijuar një paketë instrumentash dhe plan veprimi dhe u përmend gjithashtu që vet procesi i vlerësimit jashtëm është një proces që i vjen në ndihmë përmirësimeve të mëtejshme.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit i cili akreditohet për herë të parë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
"Financë - Kontabilitet"**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të veprimtarisë së Universitetit;
2. Qëndrueshmëri e stafit të Departamentit dhe bashkëpunimi i mirë i stafit me biznesin rajonal;
3. Godinat në të cilat zhvillohet veprimtaria, plotësojnë më së miri kushtet për zhvillimin e procesit mësimor
4. Marrëveshje bashkëpunimi të suksesshme me institucione homologe të huaja kryesisht me ato rajonale;

b. Pika të dobta:

1. Si një program Msc në Finance Kontabilitet nuk reflekton plotësisht nivelin e trajtimit të thelluar shkencor në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut; *(Standardi II.1. Kriteri 2)*
2. Numri i lartë i lëndëve që zhvillohen nga një pedagog dhe ngarkesa mësimore mbi normativën ligjore; *(Standardi IV.1, kriteri 2)*
3. Tekstet e lëndëve për literaturën bazë ashtu dhe për atë të rekomanduar të vendosur në programet e lëndëve janë kryesisht në gjuhën shqip dhe nuk i përkasin 5 viteve të fundit; *(Standardi IV.3.kriteri 1)*
4. Mungesa e instrumentave të vlerësimit 360 gradë të programit të studimit; *(Standardi VI.3 kriteri 1)*

Rekomandime

1. Nevoja për politika mbështetëse për stafin akademik që do të përmirësonin klimën e brendshme në universitet, do të ulnin ngarkesën e pedagogëve dhe do t'i motivonin në punën e tyre. Drejtimi i universitetit nëpërmjet politikave mbështetëse duhet të synojë të ruajë dhe të rrisë me tej influencën lokale dhe atë rajonale të universitetit edhe nëpërmjet angazhimit të profesorëve të ftuar, organizimin me module të mësimi, etj;
2. Përmirësime të vazhdueshme në programin e studimit me njohuri me të thelluara në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut nëpërmjet rritjes së lëndëve me zgjedhje gjatë dy viteve akademike të zhvillimit të programit;
3. Formalizmi i marrëveshjeve në nivel fakulteti, sidomos me subjekte biznesi, dhe në marrëveshjet të merren në konsideratë dhe praktikat mësimore; si dhe të përgatitet rregullorja dhe Paketa e

dokumentacionit të Praktikës. Po në këtë kuadër ri konceptimi i punës së Zyrës së Karrierës dhe Alumnit;

4. Përmirësimi i programeve të lëndeve kryesisht në rritjen e peshës së vlerësimit të vazhduar që është në nivele të ultë si dhe përditësimi i literaturës në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore, duke i dhënë peshën e duhur literaturës në gjuhë të huaj në literaturën bazë – kryesisht të 5 viteve të fundit. Mbi këtë bazë të formulohen leksionet e pedagogut të lëndës;
5. UGJ duhet të bëjë më shumë përpjekje për të institucionalizuar procesin e matjes, krijimi të indikatorëve dhe më pas monitorimit e vlerësimit të cilësisë për programin e studimit në fjalë dhe në përgjithësi si kulturë institucionale;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Finance - Accounting"

a. Strengths and affirmations:

1. Many years of experience in the higher education market of the University's activity;
2. Stability of the staff of the Department and good cooperation of the staff with the regional business;
3. The buildings in which the activity takes place best meet the conditions for the development of the learning process;
4. Successful cooperation agreements with foreign counterpart institutions, mainly with regional ones.

b. Weaknesses:

1. As a Msc program in Finance and Accounting does not fully reflect the level of in-depth scientific treatment in the field of finance and risk management; (*Standard II.1, Criterion 2*)
2. The high number of courses taught by one lecturer and the teaching load on the legal norm; (*Standard IV.1, Criterion 2*)
3. The course texts for the basic literature as well as for the recommended one set in the course programs are mainly in Albanian and do not belong to the last 5 years; (*Standard IV.3, Criterion 1*)
4. Lack of 360 degree assessment instruments of the study program; (*Standard VI.3 Criterion 1*)

Recommendation

1. The need for support policies for academic staff that would improve the internal climate at the university, reduce the workload of lecturers and motivate them in their work. The management of the university through supporting policies should aim to preserve and further increase the local and regional influence of the university through the engagement of guest professors, the organization of program with modules, etc;
2. Continues improvements in the study program with more in-depth knowledge in the field of finance and risk management through the increase of optional subjects during the two academic years of the program development;
3. The formality of agreements at the faculty level, especially with business entities. Teaching practices should be taken into consideration in these agreements,; as well as to prepare the regulations and the Internship Documentation Package. In this context, the new conception of the work of the Career and Alumni Office;
4. Improving the syllabuses of the subjects, mainly in increasing the weight of continuous evaluation which is at low levels as well as updating the literature in accordance with the requirements of the legal framework, giving the appropriate weight to the literature in foreign languages in the basic literature – mainly of the last 5 years. The teacher's lectures should be formulated on this basis;
5. UGJ should make more efforts to institutionalize the process of measurement, creation of indicators and then monitoring of quality assessment for the study program in question and in general as an institutional culture;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X